



REPUBLIKA E KOSOVËS- REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT

Nr. 04/ 6358 /2026

DATA :	13.07.2026
PËR :	KPF dhe Kuvend Komunal
PËRMES :	Mehmet Ballazhi Kryetar i Komunës Han i Elezit
NGA :	Lindita Ballazhi Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
LËNDA :	Raporti financiar për periudhën janar-qershor 2025



I nderuar Kryesues i Kuvendit Komunal,
Të nderuar/a Anëtarë/e të Kuvendit,

Bazuar në Ligjin nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të dispozitave të nenit 45, paragrafët 45.2 dhe 45.4, si dhe Statutit të Komunës së Hanit të Elezit të nenit 51, paragrafi 51.5, gjeni të bashkangjitur raportin financiar për periudhën janar-qershor 2025.

Me respekt,



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



Nr. 04/6358 /2026

RAPORTI FINANCIAR JANAR-QERSHOR 2026

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA



Hani i Elezit, Korrik 2026

HYRJE

Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2026, është përgatitur në bazë të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të dispozitave të nenit 45, paragrafët 45.2 dhe 45.4, si dhe Statutin e Komunës së Hanit të Elezit të nenit 51, paragrafi 5. Ky raport përmban një përmbledhje të trendeve kryesore të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore përgjatë periudhës gjashtë mujore Janar-Qershor 2024. Raporti përmban analiza përmbledhëse të periudhës përkatëse, pasqyron të hyrat sipas drejtorive, sipas llojit të të hyrave si dhe krahasimet me periudhat paraprake dhe projeksionet buxhetore. Qëllimi i këtij raporti është që të njoftojë Kryetarin, Bordin e drejtorëve, Komitetin për Politikë dhe Financa si dhe Kuvendin Komunal, për realizimin e buxhetit komunal përfshirë buxhetin e secilës Drejtori – Program Buxhetor, duke filluar prej programeve të Administratës së Përgjithshme, Shëndetësisë Primare, Arsimit dhe Shkenca për periudhën Janar – Qershor 2026, duke përfshirë kategoritë ekonomike të pagave dhe shtesave, mallra dhe shërbimet, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere si dhe investimet kapitale.

Realizimin i të hyrave vetanake komunale dhe strukturën e tyre sipas burimeve të tyre, në mënyrë analitike si dhe krahasimi i tyre në raport me të njëjtën periudhë Janar-Qershor të viteve 2026/2025.

Buxheti i Komunës për vitin 2026, nënkupton Buxhetin e aprovuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, respektivisht Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2026, për komunën Hani i Elezit, të aprovuar paraprakisht edhe nga Kuvendi Komunal dhe organet e tij.

Prezantimi i të dhënave në këtë mënyrë mundëson:

- Prezantimin e raportit financiar në formë transparente dhe të tërësishme,
- Një pasqyrë për të gjitha kategoritë buxhetore: paga dhe shtesa, mallra dhe shërbimet, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere si dhe investimet kapitale,
- Mundësinë e krahasimit në mes fondit të planifikuar, të alokuar dhe të shpenzuar sipas kategorive,
- Shprehja në përqindje e shfrytëzimit të buxhetit në periudhën përkatëse.

Të dhënat e poshtë shënuara, sa i përket shpenzimeve për gjithë kategoritë buxhetore si dhe regjistrimi i të hyrave, sipas klasifikimit ekonomik janë të harmonizuara me Departamentin e Thesarit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dhe raportet që dalin nga SIMFK - Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës.

1. BUXHETI KOMUNAL 2026

Buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas Ligjit me **NR. 10/L-001 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2026** është në lartësi prej **4,234,682.00 Euro.**

Ky buxhet është ndarë sipas kategorive ekonomike si në vijim:

- Paga dhe shtesa..... 2,505,202.00 €,
- Mallra dhe shërbime..... 571,000.00 €,
- Shpenzimet komunale111,000.00 €,
- Subvencione dhe transfere ...185,000.00 €,
- Shpenzime kapitale 862,480.00 €,
- Totali i buxhetit..... 4,234,682.00 €.

Ndërsa buxheti përfundimtar është **4,957,985.57 €** ku në këtë shumë përfshihen:

1. Mjetet e ndara nga Grantet Qeveritare në shumë prej **3,877,962.00 €**,
2. Projektioni i Të Hyrave Vetanake në shumë prej **356,720.00 €**,
3. Donacioni nga Unioni Evropian për projektin dy vjeçar “A smart system for Early Floods Detection and Waste Monitoring in the Lepenc River Basin” në shumë prej **141,903.98 €**,
4. Bartja e bilancit të pashpenzuar nga viti 2025 në vitin 2026 në shumë prej **580,184.23 €**,
5. Donacion nga Këshilli i Evropës në shumë prej **1,101.68 €**,
6. Mjete të mbetura nga Grante të cilat janë bartur vit pas viti në vlerë prej **113.68 €**.

Kategoritë ekonomike	Ndarjet Buxhetore Nr: 10/L-001	Fondi 22	49 - BE - Bashkimi Evropian	Grante të mbetura	93 - Këshilli i Evropës	Total
Paga dhe shtesa	2,505,202.00					2,505,202.00
Mallra dhe shërbime	571,000.00	77,411.96	34,410.98	0.50	1,101.68	683,925.12
Shpenzime Komunale	111,000.00	27,023.23				138,023.23
Subvencione dhe transfere	185,000.00	30,000.00	25,089.00			240,089.00
Shpenzime Kapitale	862,480.00	445,748.94	82,404.00	113.18	-	1,390,746.12
Total	4,234,682.00	580,184.13	141,903.98	113.68	1,101.68	4,957,985.47

Tabela 1 – Ndarjet fillestare dhe finale buxhetore

2. TË HYRAT VETANAKE

2.1 Të Hyrat Vetanake Komunale të planifikuara, të realizuara dhe krahasimi i tyre 2026/2025

Përshkrimi	Projeksioni i të hyrave vetanake 2026	Realizimi TM1-TM2 2026	Realizimi TM1-TM2 2025	Ndryshimi 2026-2025	Krahasimi 2026/2025
Të hyrat direkte	356,720.00	101,455.62	1,073,084.60	(971,628.98)	90.55

Tabela 2 – Realizimi i të hyrave vetanake 2026-2025

-Vërejtje: në këtë tabelë të hyrat e realizuara për TM1-TM2 2026 dhe 2025 janë pa gjobat e trafikut, të Gjykatave dhe pa të Agjensionit Pyjor të Kosovës.

SQARIM:

Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelë, vërehet se TM1-TM2 të vitit 2026 kemi shënuar një rënie në arkëtimin e të hyrave krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit fiskal 2025, me një diferencë prej 971,628.98 € apo 90.55 % më pak.

Inkasimi i të hyrave vetanake përgjatë vitit 2025 është për 10.6 herë më i lartë krahasuar me vitin aktual 2026.

2.2 Krahاسimi i të hyrave të realizuara sipas kodeve ekonomike Janar-Qershor 2026/2025

Nr	Kodi	Përshkrimi	Realizimi Janar-Qershor 2026	Realizimi Janar-Qershor 2025	Krahاسimi në euro 2026-2025
1	50013	Certifikatat e lindjes	35.00	37.50	(2.50)
2	50014	Certifikatat e kurorëzimit	11.00	50.00	(39.00)
3	50015	Certifikatat e vdekjes	51.50	6.00	45.50
4	50016	Taksa për çertifikata tjera	404.00	1,059.00	(655.00)
5	50017	Taksa për verifikimin e dok. të ndryshme	2.50	13.00	(10.50)
6	50019	Taksa tjera administrative	340.00	301.00	39.00
I	163	Administrata e Përgjithshme	844.00	1,466.50	(622.50)
7	40110	Tatimi në pronë dhe në tokë	10,935.93	50,529.20	(39,593.27)
8	50001	Taksë për regjistrim të automjeteve	7,740.00	11,730.00	(3,990.00)
II	175	Buxhet dhe Financa	18,675.93	62,259.20	(43,583.27)
9	50019	Taksa të tjera administrative	2,432.00	1,267.05	1,164.95
10	50029	Të hyrat nga ushtrimi i veprimt. afariste	400.00	665.00	(265.00)
11	50212	Licenca për reklama dhe publikime në prona publike	-	2,279.70	(2,279.70)
12	50405	Shfrytëzimi i pronës publike	-	1,860.00	(1,860.00)
13	50107	Gjobat tjera	-	1,574.90	(1,574.90)
III	180	Shërbimet Publike	2,832.00	7,646.65	(4,814.65)
14	50029	Të hyrat nga ushtrimi i veprimt. afariste	65,102.56	73,439.80	(8,337.24)
15	50205	Licenca për pranim teknik të lokalit	-	20.00	(20.00)
IV	480	Zhvillimi Ekonomik	65,102.56	73,459.80	(8,357.24)
16	50009	Taksa komunale për leje ndërtimi	20.00	112.07	(92.07)
17	50011	Taksë për ndërrim të pronarit të pronës	1,410.00	1,990.00	(580.00)
18	50026	Taksë për legalizim të objekteve	635.95	635.36	0.59
19	50012	Taksa për ndërrim të destinimit të pronës	15.50	908,571.71	(908,556.21)
20	50405	Shfrytëzimi i pronës publike	782.28	927.36	(145.08)
21	50019	Taksa tjera administrative	854.00	2,150.00	(1,296.00)
22	50504	Matja e tokës në teren	150.00	-	150.00
23	50032	Taksa për çertifikatë të pronësisë dhe kopje plani	647.00	-	647.00
V	660	Urbanizimi dhe Kadastro	4,514.73	914,386.50	(909,871.77)
24	50409	Participimet në Arsim	6,480.00	8,500.00	(2,020.00)
VI	920	Arsimi	6,480.00	8,500.00	(2,020.00)
25	50019	Taksa për shërbimet sociale	73.00	147.00	(74.00)
26	50409	Participimet në shëndetësi	2,378.40	4,018.95	(1,640.55)
27	50024	Taksa për çertifikata mjekësore	555.00	1,035.00	(480.00)
VII	730	Shëndetësia dhe MS	3,006.40	5,200.95	(2,194.55)
28	50405	Shfrytëzimi i pronës publike	-	165.00	(165.00)

VIII	850	Kulturë, Rini dhe Sport	-	165.00	(165.00)
A		TË HYRAT DIREKTE	101,455.62	1,073,084.60	(971,628.98)
29	50101	Të hyrat nga dënimet në trafik	56,680.00	46,460.00	10,220.00
30		Të hyrat nga Agjensioni Pyjor	392.48	198.75	193.73
B		TË HYRAT INDIREKTE	57,072.48	46,658.75	10,413.73
		TOTALI I PËRGJITHSHËM (A + B)	158,528.10	1,119,743.35	(961,215.25)

SQARIME:

Përgjatë periudhës raportuese janar-qershor 2026 inkasimi i të hyrave vetanake në kuadër të Drejtorive është si vijon:

- Administrata e Përgjithshme ka inkasuar 844.00 €. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak inkasimi është më i ulët për 622.50 €.
- Drejtoria për Buxhet dhe financa ka inkasuar 18,675.93 €. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak inkasimi është më i ulët për 43,583.27 €.
- Drejtoria e Shërbimeve Publike ka inkasuar 2,832.00 €. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak inkasimi është më i ulët për 4,814.65 €.
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit ka inkasuar 65,102.56 €. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak inkasimi është më i ulët për 8,357.24 €.
- Drejtoria e Urbanizmit dhe Kadastrit ka inkasuar 4,514.73 €. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak inkasimi është më i ulët për 909,871.77 €.
- Drejtoria e Arsimit ka inkasuar 6,480.00 €. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak inkasimi është më i ulët për 2,020.00 €.
- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka inkasuar 3,006.40 €. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak inkasimi është më i ulët për 2,194.55 €.
- Të hyrat indirekte gjatë periudhës raportuese janë në shumë prej 56,680.00 € nga Gjobat në trafik dhe 392.48 € nga Agjensioni Pyjor i Kosovës. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak këto të hyra janë më të larta për 10,413.73 €.

SQARIM SHITESË: Të hyrat e periudhës raportuese janar-qershor 2026 nuk janë plotësisht të sakta, si pasojë e mungesës së zyrtarit për regjistrim të të hyrave vetanake. Rrjedhimisht, të hyrat vetanake nuk janë regjistruar nga muaji prill deri në muajin qershor. Kur të pajisemi me qasje për regjistrimin e të hyrave në SIMFK, të njëjtat do të regjistrohen manualisht dhe do të reflektohen në raportet vijuese.

3. Ekzekutimi i buxhetit janar-qershor 2026 sipas burimit të financimit

Përshkrimi	Buxheti Aktual	Buxheti i Alokuar	E paalokuar	Aktuali	Zotim /Obligimet në pritje	Buxheti FreeBalance	Progresi në % realizimi/alokim	Progresi në % realizim/planifikim
10 BUXHETI	3,877,962.00	2,810,187.18	1,067,774.82	1,633,372.83	357,683.40	1,886,166.57	58.12	42.11
21 TE HYRAT VETANAKE	356,720.00	51,540.07	305,179.93	40,986.60	-	315,733.40	79.52	11.49
32 GRANTE TJERA TE JASHTME	30.00	30.00	-	-	-	30.00	-	-
22- TË HYRAT E BARTURA	580,184.23	580,184.23	-	42,034.05	108,605.33	429,544.85	7.24	7.24
49 EU-UNIONI EUROPIAN	141,903.98	141,903.98	-	121,042.06	774.20	20,087.72	85.30	85.30
60 UN-HABITAT	0.26	0.26	-	-	-	0.26	-	-
61 QEVERIA ZVICRANE	83.42	83.42	-	-	-	83.42	-	-
93 Këshilli i Evropës	1,101.68	1,101.68	-	1,101.68	-	-	100.00	100.00
Totali i Përgjithshëm	4,957,985.57	3,585,030.82	1,372,954.75	1,838,537.22	467,062.93	2,651,646.22	51.30	37.10

SQARIM:

Ekzekutimi i buxhetit nga fondi burimor **10 – Granti Qeveritar** për periudhën raportuese janar-qershor 2026 është në shumë prej 1,633,372.83 € apo 58.12 % në raport me buxhetin e alokuar dhe 42.11 % në raport me buxhetin e planifikuar.

Ekzekutimi i buxhetit nga fondi burimor **21 – Të Hyrat Vetanake** për periudhën raportuese janar-qershor 2026 është në shumë prej 40,986.60 € apo 79.52 % në raport me buxhetin e alokuar dhe 11.49 % në raport me buxhetin e planifikuar.

Ekzekutimi i buxhetit nga fondi burimor **22 – Të hyrat e bartura** për periudhën raportuese janar-qershor 2026 është në shumë prej 42,034.05 € apo 7.24 % në raport me buxhetin e alokuar dhe 7.24 % në raport me buxhetin e planifikuar.

Ekzekutimi i buxhetit nga fondi burimor **49 – Unioni Evropian** për periudhën raportuese janar-qershor 2026 është në shumë prej 121,042.06 € apo 85.30 % në raport me buxhetin e alokuar dhe 85.30 % në raport me buxhetin e planifikuar.

Ekzekutimi i buxhetit nga fondi burimor **93 – Këshilli i Evropian** për periudhën raportuese janar-qershor 2026 është në shumë prej 1,101.68 € apo 100 % në raport me buxhetin e alokuar dhe 100 % në raport me buxhetin e planifikuar.

Ekzekutimi i buxhetit nga të gjithë fondet burimore për periudhën raportuese janar-qershor 2026 është në shumë prej 1,838,537.22 € apo 51.30 % nga buxheti i alokuar dhe 37.10 % nga buxheti i planifikuar. P

3.1 Ekzekutimi i buxhetit sipas Nën-Programeve Buxhetore dhe sipas Fondeve Burimore

<i>Programet(Drejtoritë)</i>	<i>Pagat dhe shtesat</i>	<i>Mallrat dhe shërbimet</i>	<i>Shpenzimet komunale</i>	<i>Subvencionet dhe transferet</i>	<i>Shpenzimet kapitalet</i>	<i>Totali i shpenzimeve</i>
<i>Totali</i>	1,437,427.18	162,137.12	46,366.20	91,075.60	101,531.12	1,838,537.22
<i>GRANTI QEVERITAR (10)</i>	1,437,427.18	133,230.38	43,388.15	-	19,327.12	1,633,372.83
<i>Zyra e Kryetarit</i>	68,571.81	19,666.24	-	-	-	88,238.05
<i>Administrata e Përgjithshme</i>	68,916.55	14,620.10	28,832.00	-	-	112,368.65
<i>Zyra e Kuvendit Komunal</i>	87,691.55	5,158.65	-	-	-	92,850.20
<i>Buxhet dhe Financa</i>	45,016.99	-	-	-	-	45,016.99
<i>Shërbime Publike dhe Emergjencia</i>	59,003.86	38,301.07	1,234.18	-	-	98,539.11
<i>Zyra lokale për Komunitete</i>	4,789.82	-	-	-	-	4,789.82
<i>Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural</i>	7,633.15	-	-	-	-	7,633.15
<i>Zhvillimi Ekonomik dhe Turizmi</i>	18,555.00	1,160.00	-	-	18,500.03	38,215.03
<i>Urbanizmi</i>	48,742.11	5,833.00	-	-	827.09	55,402.20
<i>Administrata e Shëndetësisë</i>	7,328.24	0.00	-	-	0.00	7,328.24
<i>Shërbimet e Shëndetësisë Primare</i>	203,840.13	20,134.57	4,234.11	-	-	228,208.81
<i>Shërbimet sociale</i>	16,978.67	102.00	407.66	-	-	17,488.33
<i>Shërbime Kulturore</i>	21,482.42	2,500.00	1,514.25	-	-	25,496.67
<i>Administrata e Arsimit</i>	19,768.12	22,711.00	-	-	-	42,479.12
<i>Arsimi Parafillor Çerdhja</i>	61,951.32	2,522.82	1,133.41	-	-	65,607.55
<i>Arsimi Fillor</i>	579,068.45	460.93	4,445.23	-	-	583,974.61
<i>Arsimi i Mesëm</i>	118,088.99	60.00	1,587.31	-	-	119,736.30
<i>TË HYRAT VETANAKE-21</i>	-	-	-	40,986.60	-	40,986.60
<i>Zyra e Kryetarit</i>	-	-	-	15,611.60	-	15,611.60
<i>Administrata e Arsimit</i>	-	-	-	25,375.00	-	25,375.00
<i>TË HYRAT E BARTUARA - 22</i>	-	14,056.00	2,978.05	25,000.00	-	42,034.05
<i>Zyra e Kryetarit</i>	0	4,056.00	-	25,000.00	-	29,056.00
<i>Administrata e Arsimit</i>	-	10,000.00	-	-	-	10,000.00
<i>Arsimi i Mesëm</i>	-	-	2,978.05	-	-	2,978.05
<i>49 BE - BASHKIMI EUROPIAN</i>	-	13,749.06	-	25,089.00	82,204.00	121,042.06
<i>Urbanizmi</i>	-	13,749.06	-	25,089.00	82,204.00	121,042.06
<i>93 - KËSHILLI I EVROPËS</i>	-	1,101.68	-	-	-	1,101.68
<i>Administrata e Përgjithshme</i>	-	1,101.68	-	-	-	1,101.68

3.2 Përqindja e realizimit dhe planifikimit të buxhetit për periudhën raportuese Janar – Qershor 2026 dhe krahasimi me vitin 2025

Kategoritë buxhetore	Buxheti 2026	Realizimi Janar-Qershor 2026	%	Buxheti 2025	Realizimi Janar- Qershor 2025	%	Krahasimi në euro 2026/25	Krahasimi në % 2026/25
Paga dhe shtesa	2,505,202.00	1,437,427.18	57.38%	2,283,153.84	1,126,876.70	49.36%	310,550.48	27.56
Mallra dhe shërbime	683,925.12	162,137.12	23.71%	669,507.54	305,061.31	45.57%	-142,924.19	-46.85
Shpenzime komunale	138,023.23	46,366.20	33.59%	94,000.00	46,486.86	49.45%	-120.66	-0.26
Subvencione dhe trans.	240,089.00	91,075.60	37.93%	148,000.00	106,474.68	71.94%	-15,399.08	-14.46
Investime Kapitale	1,390,746.12	101,531.12	7.30%	878,351.27	173,638.89	19.77%	-72,107.77	-41.53
TOTAL	4,957,985.47	1,838,537.22	37.08%	4,073,012.65	1,758,538.44	43.18%	79,998.78	4.55

SQARIME:

- Shpenzimi i kategorisë buxhetore Paga dhe Shtesa për periudhën raportuese Janar-Qershor 2026 është në shumë prej 1,437,427.18 € apo 57.38 % nga buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak 2025 shpenzimi për këtë kategori është më i lartë për 310,550.48 € apo 27.56 % më shumë.
- Shpenzimi i kategorisë buxhetore Mallra dhe Shërbime për periudhën raportuese Janar-Qershor 2026 është në shumë prej 162,137.12 € apo 23.71% nga Buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025 shpenzimi për këtë kategori buxhetore ka shënuar një rënie prej 142,924.19 € apo 46.85 % më pak shpenzim.
- Shpenzimi i kategorisë buxhetore Shpenzime Komunale për periudhën Janar-Qershor të vitit 2026 është në shumë prej 46,366.20 € apo 33.59% nga Buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025 shpenzimi për këtë kategori përgjatë vitit 2026 është më i ulët për 120.66 € apo 0.26 % më pak.
- Shpenzimi i kategorisë buxhetore Subvencione dhe Transfere për periudhën Janar-Qershor të vitit 2026 është në shumë prej 91,075.60 € apo 37.93% nga buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025 shpenzimi për këtë kategori përgjatë vitit 2026 është më i ulët për 15,399.08 € apo 14.46 % më pak.
- Nga kategoria buxhetore Shpenzime Kapitale, për periudhën Janar-Qershor të vitit 2026 është në shumë prej 101,531.12 € apo 7.30% nga buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025 shpenzimi për këtë kategori përgjatë vitit 2026 është më i ulët për 72,107.77 € apo 41.53 % më shumë.

Shpenzueshmëria totale e Buxhetit për periudhën raportuese Janar-Qershor 2026, duke i përfshirë të gjithë kategoritë buxhetore është në shumë prej 1,838,537.22 € apo 30.08%. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak 2025, shpenzimi total ka shënuar rritje prej 79,998.78 € apo 4.55% më shumë.

3.3 Ekzekutimi i buxhetit sipas Planit Kontabël

3.3.1 Kategoria buxhetore Paga dhe shtesa

Kodi	Përshkrimi	Shpenzimi Janar-Qershor 2026	Shpenzimi Janar-Qershor 2025	Krahasimi 2026-2025	Krahasimi në %
1	Paga dhe shtesa				
11111	Pagat neto	966,140.53	888,028.44	78,112.09	8.80
11121	Tatimi në të ardhura personale	85,791.47	58,415.34	27,376.13	46.86
11131	Kontributi pensional - Punëtori	67,594.91	53,180.76	14,414.15	27.10
11211	Përvoja e punës	70,779.11	42,555.90	28,223.21	66.32
11311	Kontributi pensional - Punëdhënësi	67,594.91	53,180.76	14,414.15	27.10
11411	Shtesa e veçantë për të zgjedhurit	6,018.09	11,574.01	-5,555.92	-48.00
11416	Shtesa për vëllimin e punës	-	1,492.99	-1,492.99	-100.00
11151	Sindikatat	2,446.52	1,943.49	503.03	25.88
11152	Odat profesionale	1,251.11	970.62	280.49	28.90
11431	Kujdestaria, puna gjatë natës dhe puna jashtë orarit të punës	18,830.80	15,534.39	3,296.41	21.22
11413	Shtesa e performancës	150,979.73	-	150,979.73	#DIV/0!
	Totali për paga dhe shtesa	1,437,427.18	1,126,876.70	310,550.48	27.56

SQARIME:

11111 – Pagat neto – Vlera e ekzekutuar për këtë kod ekonomik për periudhën janar – qershor 2026 është 966,140.53 €. Këtu përfshihen të gjithë pagat e rregullta neto për nëpunësit e Administratës Komunale, Sektorit të Arsimit, Shëndetësisë, Shërbimet Sociale dhe Zjarrëfikësit. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi shënuar rritje të shpenzimit për 78,112.09 € apo 8.80%.

11121- Tatimi në të ardhura personale - Vlera e ekzekutuar për këtë kod ekonomik për periudhën janar – qershor 2026 është 85,791.47 €. Këtu përfshihen të gjithë pagesat e tatimeve për të ardhurat personale për nëpunësit e Administratës Komunale, Sektorit të Arsimit, Shëndetësisë, Shërbimet Sociale dhe Zjarrëfikësit. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi shënuar rritje të shpenzimit për 85,791.47 € apo 46.86%.

11131 - Kontributi pensional – Punëtori - Vlera e ekzekutuar për këtë kod ekonomik për periudhën janar – qershor 2026 është 67,594.91 €. Këtu përfshihen 5% nga punëmarrësi e pagesës së kontributeve për nëpunësit e Administratës Komunale, Sektorit të Arsimit, Shëndetësisë, Shërbimet Sociale dhe Zjarrëfikësit. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi shënuar rritje të shpenzimit për 14,414.15 € apo 27.10%.

11211 - Përvoja e punës - Vlera e ekzekutuar për këtë kod ekonomik për periudhën janar – qershor 2026 është 70,779.11 €. Këtu përfshihet pagesa e përvojës së punës nëpunësit e Administratës Komunale, Sektorit të Arsimit, Shëndetësisë, Shërbimet Sociale dhe Zjarrëfikësit. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi shënuar rritje të shpenzimit për 28,223.21 € apo 66.32%.

11311 - Kontributi pensional – Punëdhënësi - Vlera e ekzekutuar për këtë kod ekonomik për periudhën janar – qershor 2026 është 67,594.91 €. Këtu përfshihen 5% nga punëdhënësi e pagesës së kontributeve përfshirë Administrata Komunale, Sektori i Arsimit, Shëndetësisë, Shërbimet Sociale dhe Zjarrëfikësit. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi shënuar rritje të shpenzimit për 14,414.15 € apo 27.10%.

11411 - Shtesa e veçantë për të zgjedhurit - Vlera e ekzekutuar për këtë kod ekonomik për periudhën janar – qershor 2026 është 6,018.09 €. Këtu përfshihen shtesat që ju takojnë Asamblesë Komunale për pjesëmarrje në Komitetet obligative. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi shënuar rënie të shpenzimit për 5,555.92 € apo 48 %.

11151 – Sindikatat - Vlera e ekzekutuar për këtë kod ekonomik për periudhën janar – qershor 2026 është 2,446.52 €, në të cilën përfshihen pagesat për Sindikatë në Sektorin e Arsimit dhe Shëndetësisë. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi shënuar rritje të shpenzimit për 503.03 € apo 25.88%.

11152 - Odat profesionale - Vlera e ekzekutuar për këtë kod ekonomik për periudhën janar – qershor 2026 është 1,251.11 € në Sektorin e Shëndetësisë. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi shënuar rritje të shpenzimit për 280.49 € apo 28.90%.

11431 - Kujdestaria, puna gjatë natës dhe puna jashtë orarit të punës - Vlera e ekzekutuar për këtë kod ekonomik për periudhën janar – qershor 2026 është 18,830.80 € në Sektorin e Shëndetësisë, Sektorin e Arsimit, Shërbimi Social dhe punët e zhvilluara jashtë orarit të punës nga shërbimi civil. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi shënuar rritje të shpenzimit për 3,296.41 € apo 21.22%.

11413 - Shtesa e performancës - Vlera e ekzekutuar për këtë kod ekonomik për periudhën janar – qershor 2026 është 150,979.73 €, në të cilën përfshihet paga e trembëdhjetë për nëpunësit e Administratës Komunale, Sektorit të Arsimit, Shëndetësisë, Shërbimet Sociale dhe Zjarrëfikësit.

3.3.2 Kategoria buxhetore Mallra dhe Shërbime

2 Mallrat dhe shërbimet		Shpenzimi Janar- Qershor 2026	Shpenzimi Janar- Qershor 2025	Krahasimi 2026-2025	Krahasimi në %
13130	Transporti i udhëtimit zyrtar brenda vendit	9,513.00	14,622.40	-5,109.40	- 34.94
13140	Transporti i udhëtimit zyrtar jashtë vendit	230.00	346.00	-116.00	- 33.53
13310	Interneti	465.00	1,114.00	-649.00	- 58.26
13320	Telefonia mobile	6,891.88	6,816.60	75.28	1.10
13330	Shpenzimet postare	23.70	164.10	-140.40	- 85.56
13141	Para xhepi - Mëditje për udhëtime zyrtare jashtë vendit	421.00	1,266.40	-845.40	- 66.76
13410	Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	1,000.00	6,790.00	-5,790.00	- 85.27
13430	Shërbime të ndryshme shëndetësore	10,000.00	40,000.00	-30,000.00	- 75.00
13440	Shërbime të ndryshme këshilldhënëse dhe profesionale	16,011.27	15,470.16	541.11	3.50
13445	Shërbimet e veçanta - konsulentë dhe kontraktorë individual	-	250.00	-250.00	- 100.00
13460	Shërbime kontraktuese tjera	5,977.20	4,157.12	1,820.08	43.78
13470	Shërbime teknike	-	6,354.04	-6,354.04	- 100.00
13480	Shpenzimet për anëtarësim	1,290.00	2,400.45	-1,110.45	- 46.26
13501	Mobiljet	-	2,394.00	-2,394.00	- 100.00
13509	Pajisje tjera	1,546.98	1,198.00	348.98	29.13
13610	Furnizim për zyrë	1,387.50	7,373.35	-5,985.85	- 81.18
13620	Furnizim me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	4,056.51	15,694.36	-11,637.85	- 74.15
13630	Furnizime mjekësore	2,593.00	6,186.00	-3,593.00	- 58.08
13640	Furnizime pastrimi	-	6,082.14	-6,082.14	- 100.00
13760	Drutë dhe prodhimet e drurit për ngrohje	-	1,940.00	-1,940.00	- 100.00
13780	Derivate për automjete, gjeneratorë dhe makineri	6,173.53	10,832.52	-4,658.99	- 43.01
13810	Avancë (Paradhënia) për para të imëta	-	500.00	-500.00	- 100.00
13950	Regjistrimi i automjeteve	1,175.00	555.00	620.00	111.71
13951	Sigurimi i automjeteve	-	4,002.71	-4,002.71	- 100.00
14010	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	293.00	4,859.50	-4,566.50	- 93.97
14022	Mirëmbajtja e ndërtesave administrative dhe afariste	999.00	773.00	226.00	29.24
14023	Mirëmbajtja e ndërtesave arsimore	11,200.00	12,565.00	-1,365.00	- 10.86
14024	Mirëmbajtja e ndërtesave shëndetësore	2,750.00	2,020.00	730.00	36.14
14026	Mirëmbajtja e ndërtesave sportive	998.30	-	998.30	#DIV/0!
14030	Mirëmbajtja e autorrugëve	-	5,950.57	-5,950.57	- 100.00
14032	Mirëmbajtja e rrugëve lokale	44,875.15	51,747.40	-6,872.25	- 13.28
14130	Qiraja për pajisje	340.28	-	340.28	#DIV/0!
14310	Kompenismi i përfaqësimit brenda vendit	17,489.08	22,044.93	-4,555.85	- 20.67
14410	Shpenzime-vendimet e gjykatave	-	34,837.48	-34,837.48	- 100.00

14420	Vendimet Administrative - Neni 39.2 LMFP	-	13,754.08	-13,754.08	- 100.00
14410	Vendime gjyqësore	14,436.74	-	14,436.74	#DIV/0!
	Totali për mallra dhe shërbime	162,137.12	305,061.31	-142,924.19	- 46.85

SQARIME:

13130 - Transporti i udhëtimit zyrtar brenda vendit - Shpenzimi për këtë kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2026 ka arritur në vlerë prej 9,513.00 €, për transportin e nxënësve për këto destinacione Krivenik – Hani i Elezit dhe anasjelltas, Kashan - Hani i Elezit dhe anasjelltas, Gorancë – Hani Elezit dhe anasjelltas si dhe Kaçanik – Hani i Elezit dhe anasjelltas.

13140 - Transporti i udhëtimit zyrtar jashtë vendit - Shpenzimi për këtë kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2026 ka arritur në vlerë prej 230.00 €, ka të bëjë me pagesën e biletës për udhëtim zyrtar në Gjermani nga Kryetari i Komunës.

13310 – Interneti - Shpenzimi për këtë kod ekonomik ka të bëjë me pagesën e internetit në vlerë prej 465.00 € për nevojat e Administratës Komunale, Sektorit të Arsimit, Shëndetësisë, Shërbimet Sociale dhe Zjarrëfikësit.

13320 - Telefonia mobile - Shpenzimi për këtë kod ekonomik ka të bëjë me pagesën e telefonisë mobile në vlerë prej 6,891.88 € për nevojat e Administratës Komunale, Sektorit të Arsimit, Shëndetësisë, Shërbimet Sociale dhe Zjarrëfikësit.

13330 - Shpenzimet postare - Shpenzimi për këtë kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2026 ka të bëjë me pagesën e shërbimeve postare në vlerë prej 23.70 €.

13141 - Para xhepi - Mëditje për udhëtime zyrtare jashtë vendit - Shpenzimi për këtë kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2026 është në shumë prej 421.00 € dhe ka të bëjë me pagesën e dy zyrtareve të fondeve IPA për pjesëmarrje në takime zyrtare në Maqedoninë e Veriut lidhur me projektin e IPA fondeve, pagesë e mëditjes së Udhëheqësit të Qendrës për punë Sociale për pjesëmarrje në punëtori në Maqedoni Veriore lidhur me zbatimin e planit të veprimit të përbashkët dhe një mëditje për inspektorin e komunikacionit për pjesëmarrje në Bosnjë për punëtorin “From data to action, Air Quality, Eu Accession”.

13410 - Shërbimet e arsimit dhe trajnimit – pagesa nga ky kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2026 përfshin pagesën prej 1,000.00 € për Shoqatën Profesionale të Informaticientëve të Kosovës.

13430 - Shërbime të ndryshme shëndetësore - Shpenzimi për këtë kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2026 është në shumë prej 10,000.00 € dhe ka të bëjë me pagesën e Islamic Relief duke u bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit për mbështetje me staf shëndetësor.

13440 - Shërbime të ndryshme këshilldhënëse dhe profesionale - Shpenzimi për këtë kod ekonomik për

periudhën janar-qershor 2026 është në shumë prej 16,011.27 € dhe ka të bëjë me pagesën e Këshillave Lokal, pagesën e anëtarëve të Komiteteve për Komunitete, pagesa e zyrtares së Prokurimit duke u bazuar në Marrëveshjen Ndërkomunale me Komunën e Ferizajt, pagesa e 3 zyrtarëve të fondeve IPA dhe pagesa e një eksperti nga fondet IPA lidhur me hartimin e një Strategjie.

13460 - Shërbime kontraktuese tjera - Shpenzimi për këtë kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2026 është në shumë prej 5,977.20 € dhe ka të bëjë me pagesën e ATK-së dhe të trustit për zyrtarët e fondeve IPA, pagesa e praktikantëve, pagesa e Regjisorit dhe Udhëheqësit Artistik të Festivalit Mbarëkombëtarë Hani i Elezit – 2026, pagesa e një operatori për dekorimin e xhamiave për nderë të muajit të Ramazanit.

13480 - Shpenzimet për anëtarësim - Shpenzimi për këtë kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2026 është në shumë prej 1,290.00 € dhe ka të bëjë me pagesën e anëtarësisë në AZHR lindje dhe anëtarësimi të Organizata Alda.

13509 - Pajisje tjera - Shpenzimi për këtë kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2026 është në shumë prej 1,546.98 € dhe ka të bëjë me pagesën e çipave për aparatet e kafes dhe pagesa e një lavatriçe dhe një rrobatharëse për nevoja të çerdhes.

13610 - Furnizim për zyrë - Shpenzimi për këtë kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2026 është në shumë prej 1,387.50 € dhe ka të bëjë me pagesën e petty cash-it, furnizim me letër A4 dhe pagesa e materialeve për nevoja të Çerdhes.

13620 - Furnizim me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare) - Shpenzimi për këtë kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2026 është në shumë prej 4,056.51 € dhe ka të bëjë me pagesën e byfësë komunale, pagesa e pakove festive për vizita në institucionet publike me rastin e Vitit të ri dhe pagesa e produkteve ushqimore për nevoja të Çerdhes

13630 - Furnizime mjekësore - Shpenzimi për këtë kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2026 është në shumë prej 2,593.00 € dhe ka të bëjë me pagesën e furnizimeve me materiale laboratorike.

13780 - Derivate për automjete, gjeneratorë dhe makineri - Te ky kod ekonomik janë përfshirë pagesa për derivate për gjenerator për nevoja të Administratës Komunale, Sektori i Arsimit dhe i Shëndetësisë si dhe Zjarrëfiksat në vlerë prej 6,173.53 €.

13950 - Regjistrimi i automjeteve - Shpenzimi për këtë kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2026 është në shumë prej 1,175.00 € dhe ka të bëjë me regjistrimin e automjeteve komunale.

14010 - Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve - Shpenzimi për këtë kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2026 është në shumë prej 293.00 € dhe ka të bëjë me larjen, servisimin dhe riparimin e automjeteve komunale.

14022 - Mirëmbajtja e ndërtesave administrative dhe afariste - shpenzimi për këtë kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2026 është në shumë prej 999.00 € dhe ka të bëjë me pagesën e riparimeve, defekteve të ndriçimit publik te Bllaca 99 dhe te Parku i qytetit.

14023 - Mirëmbajtja e ndërtesave arsimore - shpenzimi për këtë kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2026 është në shumë prej 11,200.00 € dhe ka të bëjë me pagesën e 4 punëtorëve për mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore për NPL "Pastrimi".

14024 - Mirëmbajtja e ndërtesave shëndetësore - shpenzimi për këtë kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2026 është në shumë prej 2,750.00 € dhe ka të bëjë me pagesën e një mirëmbajtëse për nevojat e QKMF-së.

14026 - Mirëmbajtja e ndërtesave sportive - shpenzimi për këtë kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2026 është në shumë prej 998.30 € dhe ka të bëjë me pagesën e rregullimit të ndriçimit tek sallat sportive.

14032 - Mirëmbajtja e rrugëve lokale - shpenzimi për këtë kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2026 është në shumë prej 44,875.15 € dhe ka të bëjë me pagesën NPL "Pastrimi" për mirëmbajtjen e rrugëve dhe pagesa për vendosjen e një rrethoje te Lagja e Re.

14130 - Qiraja për pajisje - shpenzimi për këtë kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2026 është në shumë prej 340.28 € dhe ka të bëjë me pagesën e makinave fotokopjuese.

14310 - Kompenismi i përfaqësimit brenda vendit - shpenzimi për këtë kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2026 është në shumë prej 17,489.08 € dhe ka të bëjë me pagesën e:

- Ushqim dhe pije për artistë me rastin e ekspozitës Bashkëbisedim me Nënloken";
- Ushqim dhe pije për mysafirë të ndryshëm me rastin e vizitës së tyre në Komunë për projekte dhe diskutime të ndryshme;
- Ushqim dhe pije për ekipin e influencerit KESH FREESTYLE nga Franca me rastin e vizitës së tyre në Han të Elezit tek Komuna dhe tek talentet e rinjë në futboll;
- Ushqim dhe pije me përfaqësues nga Zyra Rajonale e OSBE me bashkëpunëtorë dhe përfaqësues komunal gjatë takimit mes Kryetarit të Komunës dhe Drejtorit të OSBE;
- Ushqim dhe pije për vizitorë nga Komuna e Gjeorgje Petrov me rastin e bisedimeve për Ipa Fonde;
- Ushqim dhe pije për vizitorë nga Turqia me prejardhje shqiptare për mundësi bashkëpunimi;
- Pije për përfaqësuesit e KFOR dhe bashkëpunëtor të tjerë me rastin e donacionit në QKMF;
- Darkë e fundvitit për stafin e QKMF-së;
- Drekë për bashkëpunëtorë me rastin e pensionimit të mësuesit dhe shkrimtarit Shaban Çupi;

- Dreke dhe pije për kryetarin e klubit "Enduro" dhe anëtarë të tjerë të këtij klubi me rastin e vizitës në Han të Elezit;
- Pagesë për iftarin e shtruar për 40 persona për Këshillin e Bashkësisë Islame – Dega Hani i Elezit, për gratë dhe vajzat e angazhuara në KBI – Hani i Elezit dhe mysafirët e tyre nga qytete tjera;
- Meny iftari për 20 persona si dhe kafe e pije,
- Iftar i shtruar për Këshillin e Bashkësisë Islame – dega në Han të Elezit;
- Meny iftari për 25 persona, si dhe kafe për pjesëtarët e Forcave të Sigurisë së Kosovës nga Hani i Elezit,
- Meny iftari për 77 persona - iftar i shtruar për zyrtarët komunalë, anëtarët e asamblesë komunale, si dhe përfaqësues të të gjitha institucioneve lokale dhe qendrore në Han të Elezit,
- Ushqim dhe pije me rastin e Ditës së Infermierisë për stafin shëndetësor,
- Ushqim dhe pije për pjesëmarrësit në trajnimin me temë "Ngritja dhe funksionimi i Qendrës Operacionale në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera",
- Ushqim dhe pije me rastin e koktejit tek shkolla "Dardania" për 30 vjetorin e themelimit të shkollës,
- Dreke zyrtare me përfaqësues të Komunës së Çuçer Sandev – Maqedoni Veriore,
- Dreka zyrtare për tre netët e Festivalit Mbarëkombëtarë Hani i Elezit – Edicioni 4.

14410 - Vendime gjyqësore - shpenzimi për këtë kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2026 është në shumë prej 14,436.74 € dhe ka të bëjë me obligime që rrjedhin nga Kontrata Kolektive.

3.3.3 Kategoria buxhetore Shpenzime Komunale

3	Shpenzimet komunale	Shpenzimi Janar- Qershor 2026	Shpenzimi Janar- Qershor 2025	Krahasimi 2026-2025	Krahasimi në %
13210	Energjia Elektrike	36,278.36	37,308.43	-1,030.07	- 2.76
13220	Shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit	787.78	1,067.01	-279.23	- 26.17
13230	Mbeturinat	9,036.10	7,550.40	1,485.70	19.68
13250	Telefonia fikse	264.05	561.02	-296.97	-52.93
	Totali për shpenzime komunale	46,366.29	46,486.86	-120.57	- 0.26

SQARIM:

13210 - Energjia Elektrike - Ky kod ekonomik ka të bëjë me pagesën e energjisë elektrike/rrymës për periudhën raportuese janar-qershor 2026 për Administratën Komunale, Sektori i Arsimit, Sektori i Shëndetësisë dhe Zjarrëfiksat në shumë prej 36,278.36 €. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, është shënuar një rënie e shpenzimit në shumë prej 1,030.07 € apo 2.76 % më pak.

13220 - Shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit - Ky kod ekonomik ka të bëjë me pagesën e ujësjellësit dhe kanalizimit për Administratën Komunale, Sektori i Arsimit, Sektori i Shëndetësisë dhe Zjarrëfiksat në shumë prej 787.78 €. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, është shënuar një rënie e shpenzimit në shumë prej 279.23 € apo 26.17 % më pak.

13230 – Mbeturinat - Ky kod ekonomik ka të bëjë me pagesën e mbeturinave për Administratën Komunale, Sektori i Arsimit, Sektori i Shëndetësisë dhe Zjarrëfiksat në shumë prej 9,036.10 €. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, është shënuar një rritje e shpenzimit në shumë prej 1,485.70 € apo 19.68 % më shumë.

13250 - Telefonia fikse - Ky kod ekonomik ka të bëjë me pagesën e telefonisë fikse për Administratën Komunale dhe Sektori i Shëndetësisë në shumë prej 264.05 €. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, është shënuar një rënie e shpenzimit në shumë prej 296.97 € apo 52.93% më pak.

3.3.4 Kategoria buxhetore Subvencione dhe Transfere

4	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimi Janar- Qershor 2026	Shpenzimi Janar- Qershor 2025	Krahasimi 2026-2025	Krahasimi në %
21110	Subvencione për entitete publike	25,000.00	-	25,000.00	#DIV/0!
21200	Subvencione për entitete jo-publike	5,092.00	36,225.00	-31,133.00	-85.94
22100	Transfere për qeveri tjera	25,089.00	-	25,089.00	#DIV/0!
22202	Transfere për përfitues individual tjerë	35,894.60	57,649.68	-21,755.08	-37.74
22300	Vendime gjyqësore	-	12,600.00	-12,600.00	-100.00
	Totali në subvencione dhe transfere	91,075.60	106,474.68	-15,399.08	-14.46

SQARIM:

21110 - Subvencione për entitete publike – Shpenzimi nga ky kod ekonomik në shumë prej 25,000.00 € ka të bëjë me Vendimin e Kuvendit Komunal me Nr. 01/3024/2026 për rritjen e buxhetit për NPL “Pastrimi” Sh.a.

21200 - Subvencione për entitete jo-publike – Shpenzimi nga ky kod ekonomik ka të bëjë me pagesën e Banjës së Kllokotit për rehabilitimin e familjeve të Dëshmorëve, pagesa e Qendrës për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve si dhe pagesa për rehabilitimin e Handikos në Banjën e Kllokotit.

22100 - Transfere për qeveri tjera – Shpenzimi nga ky kod ekonomik ka të bëjë me transferin e një shume të donacionit të fondeve IPA, në institucionet partnere në Maqedoninë e Veriut lidhur me projektin A smart system for Early Floods Detection and Waste Monitoring in the Lepenc River Basin.

22202 - Transfere për përfitues individual tjerë - pagesa nga ky kod ekonomik për periudhën janar-qershor 2026 ka të bëjë me bursat e studentëve, përkrahjen e lehonave, ndihma financiare për qytetarë në gjendje të rënda shëndetësore, pagesa e një pjese për subvencionimin e pajisjeve bujqësore për fermerët.



HANI I ELEZIT

Nr. 04 / 6357 / 2026

DATA:	13.07.2026
PËR:	KPF dhe Kuvend Komunal
PËRMES:	Mehmet Ballazhi Kryetar i Komunës së Hani të Elezit
NGA:	Lindita Ballazhi Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
LËNDA:	Raporti i Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës Hani i Elezit për vitin 2025 nga Zyra Kombëtare e Auditimit

I nderuar Kryesues i Kuvendit Komunal,
Të nderuar/a Anëtar/e të Kuvendit Komunal,


Gjeni të bashkangjitur Raportin e Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2025 nga Zyra Kombëtare e Auditimit, me numër protokolli 04/47/1101 e datës 23.06.2026.

Me respekt,





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2025

Raporti i nënshkruar nga

Vlora Spanca,

Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Hanit të Elezit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Hanit të Elezit (KHE), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Hanit të Elezit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Pasqyrat Financiare Vjetore nuk prezantojnë një informacion të plotë dhe të saktë, ato përmbajnë gabime në raportimin e zërave kontabël nëpër pozicione të caktuara.
- B1 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale të prezantuara në PFV ishin të nënvlerësuara për 355,607€.
- B2 Keqklasifikimi i shpenzimeve nëpër kategori ekonomike në vlerë 53,791€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Hanit të Elezit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

B3 Vonesa në pagesën e faturave dhe shpenzime tjera shtesë për pagesat e ekzekutuara nga thesari

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i komunës së Hanit të Elezit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i komunës së Hanit të Elezit është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

ZKF është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, ZKF është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i komunës së Hanit të Elezit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Hanit të Elezit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Hanit të Elezit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Hanit të Elezit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Hanit të Elezit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skeptizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Hanit të Elezit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të dukshme, rreth menaxhimit financiar dhe kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: nënvlerësimi i pasurive dhe keqklasifikim i shpenzimeve. Përderisa çështjet e pajtueshmërisë që kanë rezultuar lidhen me vonesat në pagimin e obligimeve financiare, dobësi në përgatitjen e raportit vjetor financiar dhe me mos themelimin të Njesisë së Auditimit të Brendshëm.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollin e brendshëm lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Pas rishikimit të PFV-ve 2025 janë identifikuar gabime dhe duke u bazuar në rekomandimet e auditorit në shkurt 2026, menaxhmenti ka ndërmarrë masa pjesërisht për korrigjimin e pasqyrave financiare, duke siguruar që ato të jenë të sakta dhe në përputhje me kërkesat ligjore por nuk janë korrigjuar në tërësi gabimet e identikuara në përputhje me rekomandimet tona.

Ky raport ka rezultuar me pesë (5) rekomandime, prej tyre një (1) rekomandim i ri dhe katër (4) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Dobësi në përgatitjen e raportit vjetor financiar për vitin 2025

Gjetja

Neni 6 i Rregullores MF.Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: "Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare".

Gjatë auditimit janë identifikuar disa pasaktësi dhe mospërputhje në shpalosjet e PFV-ve, si në vijim:

-Te Neni 14.6 - Shpalosja e ndarjeve fillestare, buxheti fillestar për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve është prezantuar në vlerë 584,500 €, ndërsa vlera e saktë duhej të ishte 588,500 €, duke rezultuar në mbivlerësim prej 4,000 €.

-Te Shënimi 9 - Të hyrat jo tatimore, është prezantuar vlera totale 1,366,200 €, ku gabimisht janë përfshirë edhe gjokat nga policia dhe donacionet/grantet; sipas shënimeve të thesarit, vlera e saktë duhej të ishte 1,070,428 €, duke rezultuar në mbivlerësim prej 295,772 €.

-Te Shënimi 11 - Grantet e përcaktuara të donatorëve janë prezantuar në vlerë 246,810 €, ndërsa në Nenin 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit, përkatësisht në kolonën e realizimit për këtë kategori, është prezantuar vlera 177,400 €, duke reflektuar mungesë konsistence ndërmjet pasqyrave financiare dhe shënimeve shpjeguese.

-Te Neni 16 - Raporti për të arkëtueshmet për vitin 2025, nuk është prezantuar vlera e tatimit në pronë, gjersa në vitin 2024 ishte raportuar vlera 200,431 €.

-Te Neni 18 - Detyrimet kontingjente për vitin 2025, nuk është prezantuar vlera e tatimit në pronë, ndërsa në vitin 2024 ishte raportuar vlera 154,808 €.

-Te Neni 28 - Raporti për gjendjen e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit nuk është plotësuar tabela, pavarësisht se paraqitja e tij është kërkesë e detyrueshme në kuadër të shpalosjeve të PFV-ve.

Kjo ka ndodhur për shkak kontrollit dobët të brendshëm dhe mungesës së rishikimit të duhur gjatë përgatitjes së PFV-ve.

Ndikimi

Mos prezantimi i saktë i PFV-ve, pamundëson që lexuesit të kuptojnë gjendjen e saktë të Komunës. Po ashtu, mungesa e informatave të plota në shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare ndikon në paraqitje jo të drejtë dhe të vërtetë të pasqyrave financiare.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të shtoj kontrollin gjatë përgatitjes së PFV-ve, në mënyrë që tabelat dhe shpalosjet për vitin 2026 të mos përmbajnë gabime dhe të ndërmerr masa adekuate ndaj personave përgjegjës për mos prezantim të saktë të të dhënave në PFV për dy vite radhazi. Po ashtu, duhet të sigurohet se deklarata e dhënë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar nuk nënshkruhet, nëse nuk janë zbatuar të gjitha kontrollin e nevojshme sipas draft PFV-ve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Nënvlërsim i regjistrin të pasurisë në PFV

Gjetja

Neni 6 paragrafi 3 i Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore përcakton që - pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin "e-pasuria". Po ashtu neni 11 paragrafi 1 dhe 2 i rregullores përcakton se pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim dhe nuk zhvlerësohen.

Nënvlërsimi total i pasurive ishte për 355,607€, pasuritë e prezantuara në PFV-të e vitit 2024 ishin nënvlërësuar për 177,172€, për shkak se investime të paguara gjatë për ndërtimin e rrugëve, trotuareve, kanalizimeve, infrastrukturës shkollore etj, nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive kapitale të SIMFK-së. Pasuri në vlerë 139,172€, ishin projekte të përfunduara dhe do të duhej të regjistroheshin si pasuri në përdorim, derisa pasuri në vlerë 38,000€¹, ishin pagesa për projekte që nuk kanë përfunduar dhe do të duhej të regjistroheshin si pasuri në vijim të cilat nuk ishin regjistruar.

Edhe gjatë vitit 2025 kemi hasur në 5 raste me vlerë 178,435€, këto pagesa nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive (Shtrimi me kubëza betoni 33,681€, rregullimi i infrastrukturës shkollore 14,778€, ndërtimi i aneksit për këmbësor 7,976€, blerja e kamionit 67,462€ dhe blerja e pajisjeve 54,538€).

Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve të dobëta në menaxhimin e pasurisë.

- Ndikimi** Mos regjistrimi i pasurive në regjistrat kontabël ndikon në nënvlerësim të pasurive dhe paraqitje jo të saktë të informative në PFV.
- Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë se është vendosur një proces efektiv i regjistrimit të pasurisë në mënyrë që regjistrat të jenë të plotë dhe të paraqesin informata të sakta me qëllim të raportimit të drejtë dhe menaxhimit adekuat të pasurisë që Komuna ka në posedim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Keqklasifikimi i shpenzimeve

- Gjetja** Ligji mbi Ndarjet Buxhetore Nr. 08/L-332 neni 15 paragrafi 12 përcakton se, ndarjet buxhetore nga rezerva me prioritet ndahen në kategorinë përkatëse të shpenzimeve për shlyerjen e vendimeve përmbartimore dhe gjyqësore me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ. Si dhe bazuar në qarkoren buxhetore me Nr. 2025/02 të lëshuar nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT) pika 3 kufijtë buxhetor për komunat, në kolonën rezerva komunat duhet të ndajnë buxhet për shlyerjen e detyrimeve kontingjente mjetet për ndarjen për detyrime kontingjente duhet ti marrin brenda kufijve të ndarë buxhetor për komunat, duke përjashtuar kategorinë paga dhe shtesa.

Gjithashtu, sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF "Mbi shpenzimin e parasë publike" shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Në dy (2) raste të pagesave në vlerë 53,791€, njëra pagesë e ekzekutuar nga Thesari për vendimet përmbartimore në vlerën 13,791€, shpenzimet që për nga natyra i takojnë pagave dhe mëditjeve që ka të bëjë me shtesë mujore në bazë të kualifikimit për punonjësit në arsim, janë paguar nga kategoria e mallra dhe shërbime dhe një pagesë tjetër në vlerë 40,000€, shpenzimi për nga natyra i takojnë kategorisë subvencion ka të bëjë me financimin e projektit 3 vjeçar "Një rrugë drejt zhvillimit në Komunën e Hanit të Elezit", ku komuna merre pjesë me 39.80% financimin e pagave të projektit, është paguar gabimisht nga kategoria mallra dhe shërbime.

Kjo ka rezultuar në mbivlerësimin financiar të shpenzimeve të kategorisë së mallrave dhe shërbimeve dhe nënvlerësimin e kategorisë së paga dhe mëditje dhe subvencione dhe transfere.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos planifikimit të duhur të buxhetit për detyrimet e mundshme në kategorinë përkatëse ekonomike.

- Ndikimi** Pagesa e shpenzimeve nga buxheti i kategorive ekonomike jo adekuate pamundëson raportim të drejtë dhe të saktë të informacionit financiar të shpenzimeve në PFV.
- Rekomandimi B2** Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet e tilla përfshihen në planifikimet buxhetore, duke mundësuar regjistrimin dhe pagesën nga buxheti i kategorive dhe kodeve ekonomike përkatëse dhe në përputhje me planin

kontabël të thesarit, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B3 - Vonesa në pagesën e faturave dhe shpenzime tjera shtesë për pagesat e ekzekutuara nga thesari

Gjetja

Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi (LMFPP) nr. 03/L-048 neni 39.1 përcakton se; çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbime e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës. Ndërsa sipas nenit 40 fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrit të prerë nga gjykata/përmbartuesi. Po ashtu ligji për marrëdhëniet detyrimeve nr. 04/L 077 neni 382.2 taksativisht parasheh; Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.

Gjatë testimit të pagesave të ekzekutuara nga komuna kemi vërejtur se në gjashtë (6) raste, faturat në vlerë totale prej 63,861€ të paraqitura në pasqyra, përfaqësojnë fatura të papaguara për më shumë se 30 ditë, me vonesë deri në 218 ditë.

Nga mostrat e testuara nuk kemi vërejtur se ka pasur kërkesa për inkasimin e mjeteve nga OE përmes procedurave përmbartimore/gjyqësore. Megjithatë, nga analiza e raportit të shpenzimeve kemi vërejtur se përmes procedurave përmbartimore/gjyqësore dhe në bazë të vendimeve gjyqësore, ishin paguar 302,930€, për kategorinë mallra dhe shërbime 203,345€, subvencione dhe transfere 12,600€ dhe investime kapitale pagesa në shumë 86,985€. Kjo formë e pagesave, përveç keqklasifikimit, ka ndikuar edhe në rritjen e shpenzimeve të procedurave përmbartimore dhe interesit.

Vetëm në një rast, vendimet/urdhër përmbartimor pagesa në vlerë 11,333€ përbëhej nga shpenzimet e procedurave kontestimore prej 1,520 dhe borxhi kryesor 9,813€.

Hyrja në obligime është si shkak i kontraktive dhe realizimeve të punëve pa pasur buxhet të mjaftueshëm dhe mos përgjegjësisë së zyrtarëve përgjegjës ka ndikuar në mosrealizimin e pagesave brenda afatit kohorë ligjor që ka rezultuar më pagesën e tyre përmes vendimeve gjyqësore/përmbartimore më shpenzime shtesë për procedurat përmbartimore/kontestimore.

Ndikimi

Si pasojë e vonesave në pagesa dobësohet aftësia e komunës për të parashikuar dhe menaxhuar likuiditetin e saj nga vendimet përmbartimore përmes thesarit ka ndikim direkt në rritjen e koston për komunën.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përmbartimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Çështja B4 - Mos themelimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm

Gjetja	Rregulloren QRK - NR 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik, neni 5 përcakton se çdo subjekti i sektorit publik me buxhet mbi tre (3) milion euro themelon Njësinë e Auditimit të Brendshëm, e cila duhet të ketë se paku dy auditor. Komuna e Hanit të Elezit edhe pse në vitin 2025 kishte buxhet afër 5 milion euro, ndërsa ende nuk e ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm, siç kërkohet me rregullën përkatëse. Kjo kishte ndodhur për shkak se Komuna nuk kishte ndërmarrë veprime të duhura për ta trajtuar çështjen e themelimit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm.
Ndikimi	Mos themelimi i NJAB-së, përveç së është në kundërshtim me kërkesat ligjore i pamundëson menaxhmentit marrjen e veprimeve për parandalimin e gabimeve të mundshme në kohe sa me të hershme.
Rekomandimi B4	Kryetari, duhet të marr veprime për themelimin dhe plotësimin e NJAB-së me staf të mjaftueshem sipas rregullores për themelimin e saj, e që njëkohsisht do të rriste dhe forconte kontrollet e brendshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ^a	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	3,615,457	4,984,586	4,362,902	3,583,669	3,453,882
Grante Qeveritare - Buxheti	3,275,738	3,420,701	3,291,050	3,034,166	3,008,702
Të bartura nga viti i kaluar	0	170,772	151,657	124,143	115,613
Të hyrat vetanake	339,719	1,146,194	707,343	155,136	298,703
Donacionet vendore	0	30	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	246,889	212,852	270,224	30,864

Buxheti fillestar për vitin 2025 ishte 3,615,457€, ndërsa buxheti final është rritur në 4,984,586€, që paraqet një rritje prej 1,369,129€ ose rreth 38%.

Shpenzimet e realizuara për vitin 2025 janë në vlerë prej 4,362,902€, që përfaqësojnë rreth 88% të buxhetit final, duke reflektuar një nivel të mirë të ekzekutimit buxhetor.

Struktura e financimit paraqitet si në vijim:

- Grantet qeveritare - buxheti mbeten burimi kryesor me realizim prej 3,291,050€;
- Të barturat nga viti i kaluar janë realizuar në vlerë prej 151,657€, duke kontribuar në financimin e aktiviteteve;
- Të hyrat vetanake janë realizuar në vlerë prej 707,343€, duke shënuar rritje të konsiderueshme krahasuar me vitet paraprake;
- Donacionet e jashtme janë realizuar në vlerë prej 212,852€, ndërsa donacionet vendore nuk kanë pasur realizim.

Krahasuar me vitin 2024, shpenzimet janë rritur për 779,233€ ose rreth 22%, ndërsa krahasuar me vitin 2023 ato janë rritur për 909,020€, duke reflektuar zgjerim të dukshëm të aktiviteteve buxhetore.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	3,615,457	4,984,586	4,362,902	3,583,669	3,453,882
Pagat dhe mëditjet	2,188,542	2,333,505	2,333,505	2,141,141	1,987,398
Mallrat dhe shërbimet	584,500	1,048,306	885,909	519,787	472,647
Komunalitë	94,000	114,000	111,623	81,220	88,798
Subvencionet dhe transferet	143,000	193,520	193,519	370,958	86,955
Investimet Kapitale	605,415	1,295,254	838,345	470,563	818,084

Shpenzimet totale për vitin 2025 janë realizuar në vlerë prej 4,362,902€, që përfaqëson rreth 88% të buxhetit final.

Ndryshimet sipas kategorive ekonomike janë si në vijim:

Buxheti final për paga dhe mëditje është rritur për 144,963€ krahasuar me buxhetin fillestar. Shpenzimet janë realizuar në vlerë prej 2,333,505€, që paraqet 100% realizim të buxhetit final. Krahasuar me vitet paraprake, kjo kategori ka shënuar rritje të qëndrueshme.


Buxheti final për mallrat dhe shërbimet është rritur për 463,806€ krahasuar me buxhetin fillestar. Shpenzimet për vitin 2025 janë realizuar në vlerë prej 885,909€, që paraqet rreth 85% të buxhetit final. Krahasuar me vitet 2024 dhe 2023, kjo kategori ka shënuar rritje të konsiderueshme.

Buxheti final për komunalitë është rritur për 20,000€ krahasuar me buxhetin fillestar. Shpenzimet janë realizuar në vlerë prej 111,623€, që përfaqëson rreth 98% të buxhetit final, duke treguar menaxhim të mirë të kësaj kategorie.

Buxheti final për subvencionet dhe transferet është rritur për 50,520€ krahasuar me buxhetin fillestar. Shpenzimet janë realizuar në vlerë prej 193,519€, që paraqet pothuajse 100% realizim. Krahasuar me vitin 2024 vërehet rënie, ndërsa krahasuar me vitin 2023 ka rritje të konsiderueshme.

Buxheti final për investimet kapitale është rritur për 689,839€ krahasuar me buxhetin fillestar. Shpenzimet janë realizuar në vlerë prej 838,345€, që përfaqëson rreth 65% të buxhetit final, duke treguar një nivel më të ulët të realizimit në këtë kategori. Krahasuar me vitet paraprake, vërehen luhatje të theksuara në realizim.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Komuna për vitin 2025 ka pranuar të hyra nga gjocat nga trafiku në vlerë 119,370€ të cilat alokohen për shpenzim në baza të rregullta tremujore. Këto të hyra janë të përfshira në tabelën e mëposhtme, pasi ato planifikohen dhe realizohen nga Ministria e Punëve të Brendshme, nuk janë përfshirë në tabelën e mëposhtme të hyrat nga Agjencioni i Pyjeve, në vlerë prej 199€.

Të hyrat e planifikuara për vitin 2025 ishin 339,719€, ndërsa realizimi i tyre ka arritur në 1,148,844€, që paraqet një tejkalim shumë të madh të planifikimit (mbi 3 herë më shumë). Realizimi i të hyrave lidhet me arkëtimin nga të hyrat nga tatimi në prone, tarifat për lëshimin e certifikatave, si dhe nga shërbime të ndryshme administrative etj.

Struktura e të hyrave paraqitet si në vijim:

- Të hyrat tatimore janë realizuar në vlerë prej 78,416€, që paraqet rënie krahasuar me planifikimin dhe vitet paraprake;
- Të hyrat jo tatimore janë realizuar në vlerë prej 1,070,428€, kjo vlerë është mbivlerësuar për shkak të përfshirjes së granteve dhe gjobave nga policia.

Krahasuar me vitin 2024, të hyrat janë rritur për 902,791€, ndërsa krahasuar me vitin 2023 ato janë rritur për 790,712€, duke reflektuar performancë shumë të lartë në mbledhjen e të hyrave.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillëstar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	339,719	339,719	1,148,844	246,053	358,132
Të hyrat tatimore	167,878	167,878	78,416	75,870	160,835
Të hyrat jo tatimore	171,841	171,841	1,070,428	170,183	197,297

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare (PFV-të) për vitin 2024 të Komunës së Hanit të Elezit (KHE) ka rezultuar me pesë (5) rekomandime për të përmirësuar efikasitetin dhe proceset. KHE ka zhvilluar një plan veprimi për të adresuar këto rekomandime në mënyrë të detajuar.

Gjatë periudhës së auditimit për vitin 2025, katër (4) nga rekomandimet nuk janë zbatuar, ndërsa një (1) është mbyllur.

Për të dhënë një shpjegim më të detajuar të çdo rekomandimi dhe si janë trajtuar ato, ju lutemi referohuni tabelës 4 në vijim.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak





Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e obligimeve dhe menaxhimin e tyre, duke siguruar fonde të mjaftueshme si dhe pagesën me kohë të faturave, në mënyrë që të shmangen kostot shtesë financiare për shkak të procedurave gjyqësore.	Nuk janë ndërmarrë veprimet për përmirësime.	Nuk ka filluar zbatimi
2.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet e tilla përfshihen në planifikimet buxhetore, duke mundësuar regjistrimin dhe pagesën nga buxheti i kategorive dhe kodeve ekonomike përkatëse dhe në përputhje me planin kontabël të thesarit, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PVF.	Nuk janë ndërmarrë veprimet për përmirësime.	Nuk ka filluar zbatimi
3.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se është vendosur një proces efektiv i regjistrimit të pasurisë në mënyrë që regjistrat të jenë të plotë dhe të paraqesin informata të sakta me qëllim të raportimit të drejtë dhe menaxhimit adekuat të pasurisë që Komuna ka në posedim.	Nuk janë ndërmarrë veprimet për përmirësime.	Nuk ka filluar zbatimi
4.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, përmes marrjes së veprimeve ligjore apo masave tjera informuese, me qëllim të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e të hyrave.	Për shkak të mungesës së informacionit për llogaritë e arkëtueshme të tatimit në prone rekomandimi është mbyllur.	Nuk është i aplikueshëm më
5.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari, duhet të marr veprime për themelimin dhe plotësimin e NJAB-së me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e saj, e që njëkohsisht do të rriste dhe forconte kontrollet e brendshme.	Nuk janë ndërmarrë veprimet për përmirësime.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Grup i Operatorëve Ekonomik "AlbAudit" SH.P.K. & "ProAudit" SH.P.K.
(Hajdar Hoxhaj, person i autorizuar në emër të grupit)



Shtojca I: Letër konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyren Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Hanit të Elezit, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përcëbjtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Mehmet Ballazhi

Pozita: Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit

Data: 08.06.2026

Nënshkrimi:



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

"E përhapur" është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA - MUNICIPALITY

HANI I ELEZIT



Nr. 04 / 6356 / 2026

DATA:	13.07.2026
PËR:	KPF dhe Kuvend Komunal
PËRMES:	Mehmet Ballazhi Kryetar i Komunës së Hani të Elezit
NGA:	Lindita Ballazhi Drejtoreshë për Buxhet dhe Financat
LËNDA:	Plani i Veprimit të zbatimit të rekomandimit të Zyres Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2025

I nderuar Kryesues i Kuvendit Komunal,
Të nderuar/a Anëtar/e të Kuvendit Komunal,

Bazuar në nenin 23, pika 5 të Ligjit Nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe duke u bazuar Raportin e Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2025 nga Zyra Kombëtare e Auditimit, me numër protokolli 04/47/1101 e datës 23.06.2026, Komuna Hani i Elezit ka përgatitur Planin e Veprimit të zbatimit të rekomandimit të Zyres Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2025.

Me respekt,

Komponenta e auditimit	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarr	Zyrtarët/et Përgjegjës/e Drejtoritë	Data e planifikuar për zbatimin e rekomandimit	Komente
1 Çështja A1 – Dobësi në përgatitjen e raportit vjetor financiar për vitin 2025	Gjatë auditimit janë identifikuar disa pasaktësi dhe mospërputhje në shpalosjet e PFV-ve, si në vijim: -Te Neni 14.6 – Shpalosja e ndarjeve fillestare, buxheti fillestar për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve është prezantuar në vlerë 584,500 €, ndërsa vlera e saktë duhej të ishte 588,500 €, duke rezultuar në mbivlerësim prej 4,000 €. -Te Shënimi 9 – Të hyrat jo tatimore, është prezantuar vlera totale 1,366,200 €, ku gabimisht janë përfshirë edhe gjokat nga policia dhe donacionet/grantet; sipas shënimeve të thesarit, vlera e saktë duhej të ishte 1,070,428 €, duke rezultuar në mbivlerësim prej 295,772 €. -Te Shënimi 11 – Grantet e përcaktuara të donatorëve janë prezantuar në vlerë 246,810 €, ndërsa në Nenin 14 – Raporti i ekzekutimit të buxhetit, përkatësisht në kolonën e realizimit për këtë kategori, është prezantuar vlera 177,400 €, duke reflektuar mungesë konsistence ndërmjet pasqyrave	Kryetari duhet të shtojë kontrollin gjatë përgatitjes së PFV-ve, në mënyrë që tabelat dhe shpalosjet për vitin 2026 të mos përmbajnë gabime dhe të ndërmerr masa adekuate ndaj personave përgjegjës për mos prezantim të saktë të të dhënave në PFV për dy vite radhazi. Po ashtu, duhet të sigurohet se deklarata e dhënë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar nuk nënshkruhet, nëse nuk janë zbatuar të gjitha kontrollat e nevojshme sipas draft PFV-ve.	Do të shtohet kontrolli gjatë hartimit të PVF 2026	ZKF Drejtoria për Buxhet dhe Financa Zyra Ligjore Drejtoritë tjera	Mars 2026	Do të shtohet kontrolli i tek mbajtja e databazave të dhënave të cilat janë pjesë e PVF

		financiare dhe shënimeve shpjeguese.							
		-Te Neni 16 – Raporti për të arkëtueshmet për vitin 2025, nuk është prezantuar vlera e tatimit në pronë, gjersa në vitin 2024 ishte raportuar vlera 200,431 €. -Te Neni 18 – Detyrimet kontingjente për vitin 2025, nuk është prezantuar vlera e tatimit në pronë, ndërsa në vitin 2024 ishte raportuar vlera 154,808 €. -Te Neni 28 – Raporti për gjendjen e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit nuk është plotësuar tabela, pavarësisht se paraqitja e tij është kërkesë e detyrueshme në kuadër të shpalosjeve të PFV-ve.							
2	Çështja B1 - Nënvlërësim i regjistrit të pasurisë në PFV	Neni 6 paragrafi 3 i Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore përcakton që - pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin “e-pasuria”. Po ashtu neni 11 paragrafi 1 dhe 2 i rregullores përcakton se pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e	Kryetari duhet të sigurojë se vendosur një proces efektiv i regjistrimit të pasurisë në mënyrë që regjistrat të jenë të plotë dhe të paraqesin informata të sakta me qëllim të raportimit të drejtë dhe menaxhimit adekuat të pasurisë që Komuna ka në posedim.	Do të shtohet kontrolli tek procesi i regjistrimit të pasurisë	Zyrtari i Pasurisë Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Dhjetor 2026	S'ka		

					investimeve në vijim dhe nuk zhvlerësohen.	
					Nënvlerësimi total i pasurive ishte për 355,607€, pasuritë e prezantuara në PFV-të e vitit 2024 ishin nënvlerësuar për 177,172€, për shkak se investime të paguara gjatë për ndërtimin e rrugëve, trotuareve, kanalizimeve, infrastrukturës shkollore etj, nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive kapitale të SIMFK-së. Pasuri në vlerë 139,172€, ishin projekte të përfunduara dhe do të duhej të regjistroheshin si pasuri në përdorim, derisa pasuri në vlerë 38,000€¹, ishin pagesa për projekte që nuk kanë përfunduar dhe do të duhej të regjistroheshin si pasuri në vijim të cilat nuk ishin regjistruar.. Edhe gjatë vitit 2025 kemi hasur në 5 raste me vlerë 178,435€, këto pagesa nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive (Shtrimi me kubëza betoni 33,681€, rregullimi i infrastrukturës shkollore 14,778€, ndërtimi i aneksit për këmbësor 7,976€, blerja e kamionit 67,462€ dhe blerja e pajisjeve 54,538€).	
					Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve të dobëta në menaxhimin e pasurisë.	

3	Cështja B2 - Këqklasifikimi i shpenzimeve Ligji mbi Ndarjet Buxhetore Nr. 08/L-332 neni 15 paragrafi 12 përcakton se, ndarjet buxhetore nga rezerva me prioritet ndahen në kategorinë përkatëse të shpenzimeve për shlyerjen e vendimeve përmbartimore dhe gjyqësore me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ. Si dhe bazuar në qarkoren buxhetore me Nr. 2025/02 të lëshuar nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT) pika 3 kufijtë buxhetor për komunat, në kolonën rezerva komunat duhet të ndajnë buxhet për shlyerjen e detyrimeve kontingjente duhet ti marrin brenda kufijve të ndarë buxhetor për komunat duke përfshirë kategorinë paga dhe shtesa. Gjithashtu sipas Rregullës Financiare Nr.01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parashë publike” shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimet Administrativ për planin kontabël. Në dy (2) raste të pagesave në vlerë 53,791€, njëra pagesë e ekzekutuar nga Thesari për vendimet përmbartimore në vlerën 13,791€, shpenzimet që për nga natyra i takojnë pagave dhe mëditjeve që ka të bëjë me shtesë mujore në bazë të	Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet e tilla përfshihen në planifikimet buxhetore, duke mundësuar regjistrimin dhe pagesën nga buxheti i kategorive dhe kodeve ekonomike përkatëse dhe në përputhje me planin kontabël të thesarit, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV.	Do të shtohet kontrolli gjatë ekzekutimit të lëndëve dhe do të bëjmë kërkesa të vazhdueshme edhe në Thesar për lëndët të cilat ekzekutohen drejtpërdrejt nga Thesari	Drejtorja për Buxhet dhe Financa	Dhjetor 2026	S'ka
---	---	---	---	---	---------------------	-------------

4	Çështja B3 - Vonesa në pagesën e faturave dhe shpenzime tjera shtesë për pagesat e ekzekutuara nga thesari	kualifikimit për punonjësit në arsim, janë paguar nga kategoria e mallra dhe shërbime dhe një pagesë tjetër në vlerë 40,000€, shpenzimi për nga natyra i takojnë kategorisë subvencion ka të bëjë me financimin e projektit 3 vjeçar "Një rrugë drejt zhvillimit në Komunën e Hanit të Elezit", ku komuna merre pjesë me 39.80% financimin e pagave të projektit, është paguar gabimisht nga kategoria mallra dhe shërbime. Kjo ka rezultuar në mbivlerësimin financiar të shpenzimeve të kategorisë së mallrave dhe shërbimeve dhe nënvlerësimin e kategorisë së paga dhe mëdijtje dhe subvencione dhe transfere.	Kryetari duhet të sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përmbartimit.	Do të shtohet kontrolli gjatë ekzekutimit të obligimeve financiare.	Zyra e Kryetarit Të gjithë krijuesit e obligimeve financiare	Dhjetor 2026	Në rastet kur mjetet mund të ekzekutohen nga Thesari, gjegjësisht prej obligimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive, mund të ketë vonesa në ekzekutim të
---	--	--	---	--	---	---------------------	--

		ashtu ligji për marrëdhëniet detyrimeve nr. 04/L 077 neni 382.2 taksativisht parasheh; Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë. Gjatë testimit të pagesave të ekzekutuara nga komuna kemi vërejtur se në gjashtë (6) raste, faturat në vlerë totale prej 63,861€ të paraqitura në pasqyra, përfaqësojnë fatura të papaguara për më shumë se 30 ditë, me vonesë deri në 218 ditë. Nga mostrat e testuara nuk kemi vërejtur se ka pasur kërkesa për inkasimin e mjeteve nga OE përmes procedurave përbarimore/gjyqësore. Megjithatë, nga analiza e raportit të shpenzimeve kemi vërejtur se përmes procedurave përbarimore/gjyqësore dhe në bazë të vendimeve gjyqësore, ishin paguar 302,930€, për kategorinë mallra dhe shërbime 203,345€, subvencione dhe transfere 12,600€ dhe investime kapitale pagesa në shumë 86,985€. Kjo formë e pagesave, përveç keqklasifikimit, ka ndikuar edhe në rritjen e shpenzimeve të procedurave përbarimore dhe interesit.					obligimeve tjera duke shfaqur në këtë mënyrë mungesë të mjeteve.
5	Çështja B4 - Mos	Rregulloren QRK - NR 01/2019 për	Kryetari, duhet të marr veprime për themelimin dhe	Do të bëjmë përpjekje të planifikojmë një	Zyra e Kryetarit	Janar-Dhjetor 2027	S'ka

themelimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm	themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik, neni 5 përcakton se çdo subjekti i sektorit publik me buxhet mbi tre (3) milion euro themelon Njësinë e Auditimit të Brendshëm, e cila duhet të ketë se paku dy auditor. Komuna e Hanit të Elezit edhe pse në vitin 2025 kishte buxhet afër 5 milion euro, ndërsa ende nuk e ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm, siç kërkohet me rregullën përkatëse. Kjo kishte ndodhur për shkak se Komuna nuk kishte ndërmarrë veprime të duhura për ta trajtuar çështjen e themelimit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm.	plotësimin e NJAB-së me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e saj, e që njëkohsisht do të rrishte dhe forconite kontrollet e brendshme.	pozitë për Auditor të brendshëm. Nëse aprovohet prej MFPT, do të vijoj plotësim-ndryshimi i Statutit të Komunës për të krijuar një Njësi të Auditimit të Brendshëm. Pas verifikimit të Ligshmërisë do të kërkohet nga DB-MFPT të krijojmë një Nën-Program të ri Buxhetor	Zyra Ligjore Drejtoria për Buxhet dhe Financa		
---	---	---	---	--	--	--

**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I KOMISIONIT TË ANKESAVE TË PALËVE NË
PROCEDURËN E DHËNJES NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME TË KOMUNËS**


Komisioni për ankesa të palëve në procedurën e dhënjes në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës (në tekstin e mëtejshëm Komisioni për Ankesa) i themeluar me Vendim të Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit me datë 29.01.2026 dhe nr. protokoli 01/nr.309/2026, në përbërje prej pesë anëtarësh dhe i kryesuar nga znj. Majlinda Kaloshi, ka ushtruar përgjegjësitë e saja të plota në pajtim me nenet 18 dhe 20 të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe nenet 18 dhe 21 të Rregullores (QRK) 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës.

Lidhur me qështjen e procedurës së dhënjes në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme komunale, përmes shprehjes së interesit, Komisioni për Ankesa konstaton se:

- I. Bazuar në afatin ligjor prej shtatë (7) ditësh për ankesa të palëve në procedurat e dhënjes në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës sipas njoftimit publik të dt.05.06.2026 dhe nr. protokoli 06/5054, njoftimit publik mbi shpalljen e ofertës fituese të publikuar nga komisioni vlerësues në tabelen e shpalljeve dhe web faqen zyrtare të komunës me dt.22.06.2026 dhe nr. protokoli 01/5577 si dhe shkresës zyrtare nga administrata komunale e dt.29.06.2026- Komisioni për Ankesa nuk ka pranuar asnjë ankesë në afatin ligjor shtatë ditor nga palët e interesuara lidhur me procedurat e konkursit publik të dhënjes në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme komunale.
- II. Nga dokumentacioni i pranuar nga Komisioni Vlerësues siç janë:
 - Njoftimi publik për dhënen në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës i dt.05.06.2026 dhe nr. protokoli 06/5054,
 - Procesverbali i hapjes publike të ofertave dt.22.06.2026,
 - Oferta fituese me nr. protokoli 01/5570,
 - Njoftimi publik të dt.22.06.2026 mbi shpalljen e ofertës fituese nr. protokoli 01/5570 si dhe:
 - Raportin përfundimtar të Komisionit Vlerësues me nr. protokoli 01/5675,

Komisioni për Ankesa ka gjetur se:

Komisioni vlerësues ka zhvilluar procedurën e dhënjes në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës në pajtim të plotë me nenin 8, 15 dhe 19 të Ligjit nr.06/L-092 për



dhënjën në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënjës në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Andaj, Komisioni për Ankesa i rekomandon Kuvendit të Komunës:

1. Ta miratoj Raportin e Komisionit për Ankesa dhe
2. Ta miratoj rekomandimin e Komisionit Vlerësues lidhur me ofertën fituese të konkursit të parashtruar nga z.Bedri Imishti- për parcelen me nr. P-73317073-00792-0 z.k. Rezhancë, vendi i quajtur Ortica- sip.19461m² me kulturë kullosë e kl.6.

Bashkëlidhur me këtë raport keni:




-Njoftimin publik për dhënjën në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme komunale dt.05.06.2026 dhe nr. protokoli 06/5054,

-Procesverbalin nga hapja publike e ofertave dt.22.06.2026,

-Ofertën fituese me nr. protokoli 01/5570 e dt.22.06.2026 si dhe

-Raportin përfundimtar të Komisionit Vlerësues.

Ky raport është përpiluar nga kryesuesja e Komisionit për Ankesa dhe është miratuar nga anëtarët e poshtë nënshkruar të komisionit:

1. Majlinda Kaloshi- kryesuese e komisionit 
2. Arbenita Bajramaliu- anëtare e komisionit 
3. Endrit Ballazhi- anëtar i komisionit _____
4. Nora Xhoni -anëtare e komisionit 
5. Hanumshahe Dibrani- anëtare e komisionit 

Hani i Elezit
03.07.2026



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo

Komuna Hani i Elezit
Municipality of Elez Han



KOMISIONI PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE DHE VLERËSIMIN E
OFERTAVE PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONAVE
TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Datë: 23.06.2026



RAPORT PËRFUNDIMITAR

MBI ZHVILLIMIN E PROCEDURËS PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË
PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS DHE VLERËSIMIN E OFERTAVE

I. Baza Ligjore

Komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave, i emëruar me Vendim të Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit- datë 29.01.2026, në përbërje prej pesë anëtarësh dhe i kryesuar nga z. Nexhmedin Daci, ka zhvilluar procedurën e dhënjes në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës përmes shprehjes së interesit duke u mbështetur në:

- Ligjin nr.06/L-092 për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës,
- Rregulloren (QRK) Nr.09/2020 për Caktimin e Procedurave të Dhënjes në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës,
- Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale- neni 14 pika 14.2,
- Statutin e Komunës së Hanit të Elezit- neni 17 pika 17.2,
- Vendimin Paraprak të Kuvendit të Komunës për Dhënjën në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronave të Paluajtshme të Komunës nr.01/Nr.303/2026 dt.29.01.2026,
- Vendimin e Kuvendit për Formimin e Komisionit për Zbatimin e Procedurave dhe Vlerësimin e Ofertave për Dhënjën në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronave të Paluajtshme të Komunës 01/Nr.307/2026,
- Vendimin për Formimin e Komisionit të Ankesave të Palëve në Procedurën e Dhënjes në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronave të Paluajtshme të Komunës nr.01/Nr.309/2026.

II. Veprimet paraprake të ndërmarra nga Komuna

Në zbatim të dispozitave ligjore të lartcekura Komuna e Hanit të Elezit para datës 31.12.2026 ka publikuar në ueb faqen zyrtare Listën e Veçantë të Pronave të Paluajtshme Komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim afatgjatë vitin 2026.

Po ashtu, me dt.29.01.2026, Kuvendi i Komunës, me propozim të Kryetarit të Komunës ka miratuar Vendimin Paraprak për Dhënjën në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronave të Paluajtshme të Komunës me nr.01/Nr.303/2026. Ky vendim është publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës.

III. Pronat e Përfshira në Procedurë

Pronat në pronësi të Komunës të miratuara për dhënje në shfrytëzim afatgjatë (15-99 vite), përmes shprehjes së interesit me një çmim fillestar prej 100€/ha në vit janë:

Nr. rendor	Nr. i parceles	Zona kadastrale	Vendi i quajtur:	Sip.m ²	kultura	destinimi
1.	73317070-00927-0	Pustenik	Nikona	11710	arë e kl. 8	Bujqësi-Blegtori
2.	73317070-00946-0	Pustenik	Tanask	8906	kullosë e kl. 4	Bujqësi-Blegtori
3.	73317073-00792-0	Rezhancë	Ortica	19461	Kullosë e kl. 6	Bujqësi-Blegtori
4.	73317073-00789-1	Rezhancë	Gjuri	9510	Kullosë e kl.5	Bujqësi-Blegtori

IV. Zhvillimi i Procedurës për Dhënjën në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronave të Lartëparaqitura

Në pajtim me nenin 15 pika 1 të Ligjit nr.06/L-092 dhe dispozitat e Rregllores (QRK) Nr.06/2020, me dt.05.06.2026 Komisioni Vlerësues ka publikuar Njoftimin Publik për Dhënjën në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronave të Paluajtshme Komunale (njoftimi me nr. protokoli 06/5054). Njoftim është publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës, tabelën zyrtare të shpalljeve, gazetën ditore me shpërndarje nacionale "Zëri" si dhe vendbanimet Gorancë dhe Pustenik. Afati për paraqitjen e ofertave ka qenë 15 ditë kalendarik duke respektuar afatet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

V. Hapja Publike dhe Vlerësimi i Ofertave

Me dt.22.06.2026, në ora 11:00, në sallën e vogël të Kuvendit Komunal është mbajtur hapja publike e ofertave. Komisioni Vlerësues konstatoi se brenda afatit ligjor prej 15 ditësh është dorëzuar vetëm një ofertë nga z.Bedri Imishti me vendbanim nga Hani i Elezit- prezent gjatë hapjes së ofertave.

VI. Vlerësim i Ofertës

Oferta e z.Bedri Imishtit ka të bëjë me parcelën P-73317073-00789 me sip.19,461m² me kulturë kullosë kl.6 vendi i quajtur Ortica z.k. Rezhancë- Hani i Elezit e renditur në tabelën e listës së veçantë me nr.3.

Pas shqyrtimit administrativ dhe financiar nga komisioni për vlerësim u konstatua:

- Oferta është dorëzuar brenda afatit sipas njoftimit publik,
- Dokumentacioni është i plotë,
- Oferta është në përputhje me kërkesat e njoftimit publik dhe
- Çmimi i ofruar është mbi çmimin minimal prej 100€/ha.

Andaj nga komisioni vlerësues oferta e z.Bedri Imishtit u vlerësua si e përgjegjshme dhe e pranueshme.

VII. OFERTA FITUESE

Pas përfundimit të vlerësimit Komisioni unanimishtë vendosi që:

z.Bedri Imishti të shpallet Ofertuesi Ekonomikishtë më i Favorshëm për parcelën nr.P-73317073-00792-0 z.k. Rezhancë, vendi i quajtur Ortica, sip.19,461m² me kulturë kullosë e kl.6 pronë e Komunës Hani i Elezit.

VIII. PUBLIKIMI I REZULTATIT

Në përputhje me parimet e transparencës, barazisë dhe ligjshmërisë, Komisioni Vlerësues me dt.22.06.2026, ka publikuar Njoftimin për Shpalljen e Ofertuesit Fitues në ueb faqen zyrtare të Komunës dhe tabelën e shpalljeve (njoftimi me nr. protokoli 01/5577).

IX. KONSTATIMI I KOMISIONIT:

Komisioni konstaton se:

- ✓ Procedura është zhvilluar në pajtim me Ligjin,
- ✓ Është respektuar konkurrenca e lirë,
- ✓ Është siguruar transparenca publike,
- ✓ Vlerësimi është bërë në mënyrë të paanshme,
- ✓ Oferta fituese është në interesin më të mirë ekonomik të komunës.

X. REKOMANDIMI PËR KUVENDIN E KOMUNËS

Duke u bazuar në Ligjin Nr.06/L-092, Rregulloren (QRK) Nr.06/2020, procesverbalin e hapjes publike si dhe vlerësimin e ofertës Komisioni i rekomandon Kuvendit të Komunës që:

1. Të miratoj raportin e Komisionit Vlerësues,
2. Të aprovoj rezultatin e procedurës nga hapja publike e ofertave,
3. Të autorizoj Kryetarin e Komunës që, në pajtim me nenet përkatëse të ligjit të lidhë: Kontratë për dhënjën në shfrytëzim afatgjatë me z.Bedri Imishti si ofertues i përzgjedhur për parcelen me nr.P-73317073-00792 z.k. Rezhancë, vendi i quajtur Ortica sip.19,461m² pronë e Komunës Hani i Elezit.

Pjesë e këtij raporti janë:

- Njoftimi publik për dhënjën në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme komunale,
- Procesverbali nga hapja publike e ofertave për dhënjën në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme komunale,
- Procesverbali nga mbledhja e Komisionit Vlerësues lidhur me miratimin e ofertës më të favorshme,
- Oferta fituese e z.Bedri Imishti,
- Njoftimi për shpalljen e ofertës fituese të konkursit publik për dhënjën në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës si dhe
- Dëshmi mbi transparencën e procesit.

Ky raport është përpiluar nga kryesuesi i Komisionit Vlerësues z.Nexhmedin Daci dhe është miratuar dhe nënshkruar nga anëtarët e Komisionit:

1.Nexhmedin Daci, kryesues

2.Shefket Lusnjani, anëtar

3. Ibadete Kalisi, anëtare

4. Mevlane Kalisi, anëtare

5. Abduraman Bushi, anëtar



Hani i Elezit

23.06.2026



REPUBLIKA E KOSOVËS- REPUBLIC OF KOSOVA
MUNICIPALITY OF ELEZ HAN
KOMUNA HANI I ELEZIT

Bazuar në nenin 8 paragrafi 1 pika 1.2 dhe nenin 15 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 15 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Caktimin e Procedurave të Dhënjës në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Vendimit Paraprak të Kuvendit të Komunës për Dhënjën në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronave të Paluajtshme të Komunës nr.01/Nr.303/2026 të dt.29.01.2026, Komisioni për Zbatimin e Procedurave dhe Vlerësimin e Ofertave për Dhënjën në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronave të Paluajtshme të Komunës- i themeluar me vendim të Kuvendit të Komunës me nr.01/Nr.307/2026 të dt.29.01.2026, shpallë këtë:

**NJOFTIM PËR PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME KOMUNALE**

Me të cilin ftohen të gjithë të interesuarit, që të shfrytëzojnë të drejtën e bazuar në ligj për pjesëmarrje përmes shprehjes së interesit për marrjen në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme komunale, si më poshtë vijon:

1. Pronat e paluajtshme për dhënjën në shfrytëzim afatgjatë:

Nr. rendor	Nr. i parceles	Zona kadastrale	Vendi i quajtur:	Sip.m ²	kultura	destinimi
1.	73317070-00927-0	Pustenik Hani i Elezit	Nikona	11710	arë e kl. 8	Bujqësi-Blegtori
2.	73317070-00946-0	Pustenik Hani i Elezit	Tanask	8906	kullosë e kl. 4	Bujqësi-Blegtori
3.	73317073-00792-0	Rezhancë Hani i Elezit	Ortica	19461	Kullosë e kl. 6	Bujqësi-Blegtori
4.	73317073-00789-1	Rezhancë Hani i Elezit	Gjuri	9510	Kullosë e kl.5	Bujqësi-Blegtori

2. Afati i dhënjes në shfrytëzim dhe çmimi fillestar: Parcelet e lartëshënuara do të jepen në shfrytëzim për një periudhë kohore afatgjatë që nënkupton periudhën kohore prej 15 vite deri në 99 vite me një çmim fillestar prej 100€ për ha/vit.

3. Qëllimi i dhënjes në shfrytëzim afatgjatë: Parcelet e lartëshënuara do të jepen në shfrytëzim palëve të interesuara me qëllim të shfrytëzimit efektiv të pronës së paluajtshme të Komunës, zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik përmes nxitjes dhe zhvillimit të sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë në vendbanimet rurale të Komunës.

4. Destinimi i parceleve: Parcelet e lartëshënuara janë të destinuara për zhvillim të aktiviteteve bujqësore: mbjellje të kulturave të ndryshme bujqësore, aktiviteteve nga fusha e blegtorisë: shfrytëzim si kullosa, ngritje të minifermave dhe aktivitete të ngjajshme.

5. E drejta e pjesmarrjes në ankand publik: Të drejtë pjesmarjeje në ankandin publik kanë të gjithë personat fizik dhe juridik që janë të evidentuar dhe regjistruar në Republikën e Kosovës.

6. Kriteret për zgjedhjen e ofertave: Zgjedhja e ofertës për dhënjen në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës bazohet në:

- (a) çmimin më të lartë të çirasë të ofruar për një hektar/vit (75% të poenave)
- (b) vlerës së planifikuar për investime pesë vitet e para (15% të poenave) dhe
- (c) numrit të planifikuar të të punësuarve pesë vitet e para (10% të poenave).

Ofertat me çmim nën 100€/ha për vit pra nën çmimin fillestar të përcaktuar nga Kuvendi i Komunës do të refuzohen.

7. Kushtet e përgjithshme:

a) **Personat fizik** të cilët marrin pjesë në konkurim përmes shprehjes së interesit aplikacionit duhet t'ia bashkangjesin kopjen e letërnjoftimit dhe dëshmin nga komuna mbi shlyerjen e obligimeve në emër të tatimit në pronë.

b) **Personat juridik** të cilët marrin pjesë në konkurim përmes shprehjes së interesit aplikacionit duhet t'ia bashkangjesin çertifikatën e regjistrimit të biznesit, vërtetimin nga administra tatimore e Kosovës për kryerjen e të gjitha detyrimeve tatimore, dëshmi për shlyerjen e detyrimeve në emër të taksës për ushtrim të veprimtarisë nëse biznesi ushtron veprimtarinë e tijë në territorin e komunës si dhe dëshmi për pagesën e tatimit në pronë deri më 31.12.2025 viti.

c) Ofertuesit që nuk i bashkangjisin të gjitha dokumentet e nevojshme, diskualifikohen dhe oferta e tyre nuk do të shqyrtohet fare.

8. Afati për aplikim: pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit të njoftimit publik në ueb faqen e komunës, tabelen e shpalljeve dhe vendet publike- nga data 05.06.2026 deri me datë 19.06.2026 në orën 15.

9. Procedurat e ofertimit: Aplikacioni për pjesmarrje mundë të tërhiqet gjdo ditë pune prej orës 8.30-15h në zyren e kadastrit-kati i parë (I) objekti i komunës.

Ofertat me dokumentet e plotësuara duhet të dorëzohen në pliko (zarf) të mbyllura në objektin e komunës kati (I) në QSHQ (Qendra e Shërbimit të Qytetarëve) me ç'rast zyrtari përgjegjës do ti protokoloj dhe do t'ju dorëzoj një dëshmi të aplikimit.

10. Vendi dhe koha e hapjes së ofertave: Hapja e ofertave të mbyllura do të bëhet me dt.22.06.2026 në sallën e kuvendit të komunës kati parë (I) duke filluar nga ora 11:00h me prezencën e drejtëpërdrejtë të pjesmarrësve në konkurim. Po të njejtën ditë Komisioni për Zbatimin e Procedurave dhe Vlerësimin e Ofertave do të shpall ofertat më të favorshme dhe të njejtat do ti publikoj në ueb faqen e komunës si dhe tabelën e shpalljeve.

11. Të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesmarrësve (ofertuesve) në konkurim: Të gjithë të interesuarit për pjesmarrje në ofertim kanë të drejtë të informohen me procedurat e ofertimit përmes shprehjes së interesit në zyren e kadastrit, të shohin pronat të cilat do të jepen në shfrytëzim, të ken qasje në dokumentacionin e pronave, dhe të tërhiqen nga pjesmarrja jo më vonë se tre (3) ditë para hapjes së ofertave. Po ashtu, pjesmarrësit e pakënaqur me vlerësimin e komisionit kanë të

drejtë të parashtrojnë ankesë pran Komisionit për Ankesa në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e publikimit të njoftimit publik mbi ofertat fituese.

12. Procedurat e ankandit publik: mund të zhvillohen edhe në rastin kur paraqitet vetëm një ofertues me kusht që të jenë plotësuar të gjitha kriteret tjera të përcaktuara me këtë njoftim publik.

Hani i Elezit
05.06.2026

Florim Shkreta
Kryesuesi i Kuvendit Komunal



PROCES VERBAL NGA HAPJA PUBLIKE E OFERTAVE PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SIPAS NJOFTIMIT PUBLIK TË DT.05.06.2026

Takimi filloi në ora 11h datë: 22.06.2026

Vendi i mbajtjes: salla e vogël e kuvendit komunal kati parë- objekti i komunës

Në takim morrën pjesë anëtarët e komisionit për vlerësim si dhe z.Bedri Imishti i cili prezantoi në cilsinë e pjesëmarrësit në konkurs respektivisht si ofertues.

Proces mbajtës u caktua Abduraman Bushi,-anëtar i komisionit për vlerësim.

Takimin e shpalli të hapur kryesusi i komisionit për vlerësimin e ofertave Nexhmedin Daci.

Pasi që përshëndeti të pranishmit dhe i njoftoi me procedurat ligjore për dhënjën në shfrytëzim afatgjatë të katër parceleve në pronësi të komunës sipas vendimit paraparak të kuvendit, ai tha: Sipas njoftimit nga zyrtari përgjegjës i Administratës Publike të Komunës për pranim të ofertave nga ofertuesit potencial deri në skadimin e afatit 19.06.2026 është pranuar vetëm një zarfë i mbyllur (kovertë e mbyllur formati A4). Ky zarfë i mbyllur është dorëzuar nga Bedri Imishti (ofertues i cili prezantoi në takim) me vendbanim nga Hani i Elezit. Nga personi përgjegjës i administratës zarfi është protokoluar dhe mban nr.01/5383 dt.16.06.2026.

Po ashtu, kryesuesi para fillimit të hapjes dhe vlerësimit të ofertës- konstatoi se nuk ekziston asnjë lloj i konfliktit të interes të anëtarve të komisionit vlerësues me ofertuesin e lartëpërmendur.

Kryesuesi i komisionit vazhdoi, në prani të anëtarve të komisionit vlerësues dhe ofertuesit me hapjen e zarfit të mbyllur me ç'rast u konstatua:

1. Ofeta në emër të Bedri Imishtit, ka të bëjë me parcelen me nr.73317073-00792-0 z.k Rezhancë vendi i quajtur Ortica me sip. 19461m² me kulturë kullosë e kl.6. Ofeta është e kompletuar sa i përket dokumentacionit të kërkuar sipas njoftimit publik ndërsa çmimi i ofruar është 120€për hektar/vit që do të thotë 20€ më shumë se çmimi fillestar i përcaktuar me vendim të kuvendit komunal. Vlera e investimeve për pesë vitet e para është në shumë prej 10,000€ ndërsa numri i të punësuarve pesë vitet e para është 3 (tre punëtor). Afati i propozuar i marrjes me qira është 45 vite. I gjithë dokumentacioni përfshirë dhe ofertën u shiquan dhe verifikuan nga të pranishmit.

Më tutje kryesuesi tha:

Konstatoj se oferta e dorëzuar nga Bedri Imishti për parcelen me nr.73317073-00792-0 z.k Rezhancë me sip.19461m² me kulturë kullosë e kl.6 është e kompletuar dhe i plotëson kushtet dhe kriteret e ofertimit sipas njoftimit publik të dt.05.06.2026, andaj si i tillë shpallet oferta ekonomikisht më e favorshme dhe fituese për marrjen me qira afatgjatë të parces së lartëshënuar. Oferta e shqyrtuar do të protokolohet dhe do ti bashkëlidhet procescerbalit.

Po ashtu, kryesuesi i komisionit për vlerësimin e ofertave i njoftoi të pranishmit se për tre (3) parcelet tjera sipas njoftimit publik nuk është pranuar asnjë ofertë. Të pranishmit nuk patën asnjë vrejtje në procedurat e hapjes publike të ofertave. Takimi u mbyll në ora 11.25h.

Anëtarët e Komisionit:

1. Nexhmedin Daci _____
2. Shefket Lusnjani _____
3. Abduraman Bushi _____
4. Ibadete Kuka _____
5. Mevlane Kalisi _____

Pjesmarrja e ofertuesve në hapjen e ofertave:

1. Bedri Imishti _____

PROCESMBAJTËSI:

1. Abduraman Bushi _____

HANI I ELEZIT
22.06.2026

PROCES-VERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE DHE VLERËSIMIN E OFERTAVE PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Mbledhja filloi në ora 11.40 dat: 22.06.2026 viti

Vendi i mbajtjes: salla e vogël e kuvendit komunal kati parë- objekti i komunës

Në takim morrën pjesë : Nexhmedin Daci -kryesues i komisionit vlerësues, Shefket Lusnjani, Ibadete Kuka, Abduraman Bushi, të gjithë anëtar të komisionit. Me arsye mungoi Mevlane Kalisi.

Rendi i ditës:

1. Miratimi zyrtar i ofertës më të favorshme nga konkursi publik përmes shprehjes së interesit.

Nexhmedin Daci: Sapo përfunduar hapjen publike të ofertave lidhur me dhënjën në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës. I tërë procesi u zhvillua në pajtim me Ligjin nr.06/L-092 për dhënjën në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Rregulloren (QRK) nr.09/2020 për caktimin e procedurave të dhënjës në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe njoftimin publik të dt.05.06.2026.

Siq jeni në dijeni është pranuar vetëm një ofertë e cila i plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara me njoftimin publik andaj propozoj që oferta e z.Bedri Imishtit të shpallet zyrtarishtë oferta fituese dhe mundësisht brenda ditës fituesi i konkursit të publikohet në tabelën e shpalljeve si dhe ueb faqen zyrtare të komunës.

Ky propozim u miratua njëzërit nga anëtarët e komisionit.

Takimi përfundoi në ora 12.20h.

Procesmbajtësi: Abdurama Bushi




Anëtarët e komisionit:

Nexhmedin Daci 

Mevlane Kalisi

Shefket Lusnjani 

Ibadete Kuka 

Abduraman Bushi 

Hani i Elezit

22.06.2026



Komisionit Komunal për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënjën në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës:

Unë **Bedri Imishti**, me vendbanim nga Hani i Elezit- Republika e Kosovës shprehi interesim për marrjen me qira afatgjatë të parces me nr.P-73317073 në sipërfaqe prej 01 94 61ha (19461m²) me kulturë kullosë e kl.6 z.k. Rezhancë vendi i quajtur Ortica -dhe për këtë qëllim parashtroj këtë:

OFERTË

- Qmimi për një ha brenda vitit: 120€ (njëqindë e njëzet euro)
- Vlera e investimeve pesë vitet e para: 10,000€ (dhjetëmijë euro)
- Numri i të punsuarve pesë vitet e para: 3 punëtor dhe
- Kohëzgjatja e qirasë: 45 vite (katërdhjetë e pesë vite)

16.06.2026

Hani i Elezit

Aplikuesi:

Emri dhe mbiemri: Bedri Imishti

Nënshkrimi: Blus



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna Hani i Elezit
Municipality of Elez Han

Datë: 22.06.2026

Hani i Elezit

Komisioni Vlerësues i themeluar me vendimin e Kuvendit të Komunës Hani i Elezit me nr.01/Nr.307/2026 dt.29.01.2026, duke u bazuar në nenin 19 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 12 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënjës në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme, me qëllim të zbatimit të Vendimit Paraprak 01/Nr.303/2026 të dt.29.01.2026 të miratuar nga Kuvendi Komunal për Dhënjën në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës Komunale, si dhe Njoftimit Publik për Dhënjën në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronave të Paluajtshme të Komunës Përmes Shprehjes së Interesit me nr.06/5054 të dt.05.06.2026, shpall këtë:

Njoftim Për Shpalljen e Ofertës Fituese të Konkursit Publik për Dhënjën në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së Paluajtshme të Komunës

Pas vlerësimit të vetëm një oferte të pranuar sipas Njoftimit Publik, Komisioni Vlerësues shpallë ofertën e z.Bedri Imishti si ofertën ekonomikisht më të favorshme për marrjen në shfrytëzim afatgjatë të parces kadastrale P-73317073-00792-0 në sip.19461m² z.k. Rezhancë-Hani i Elezit. Njoftimi për ofertën e përzgjedhur i dërgohet fituesit dhe publikohet në ëeb faqen zyrtare të komunës dhe tabelen e shpalljeve.

Këshilla Juridike: Palët e pakënaqura me vlerësimin e komisionit, kanë të drejtë të parashtrajnë ankesë pranë Komisionit për Ankesa në afat prej shtatë (7) ditësh pas shpalljes së njoftimit në ëeb faqen e komunës dhe tabelen e shpalljeve.

Nexhmedin Daci


Kryesues i Komisionit Vlerësues



DËSHMI MBI TRANSPRENCËN E PROCESIT- KOMISIONI VLERËSUES

- I. Publikimi i njoftimit publik mbi dhënjën në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interes:

1.Tabela e shpalljeve:




[illegible]

3. Publikimi në f. Gorancë:



4. Publikimi në ueb faqen zyrtare të komunës:



5. Publikimi në gazetën "Zëri"

ZëRI

pronave të paluajtshme komunale, 05.06.2026

SHALLJE 05.06.2026 14:22

SHPËRNDAJE:  



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
MUNICIPALITY OF ELEZ HAN
KOMUNA HANI I ELEZIT

Bazuar në nenin 8 paragrafi 1 pikë 1.2 dhe nenin 15 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 13 të Rregullores (ORK) Nr.09/2020 për Çaktimin e Procedurave të Dhënjës në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Vendimit Paraprak të Kuvendit të Komunës për Dhënjën në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronave të Paluajtshme të Komunës nr.01/Nr.303/2026 të dt.29.01.2026, Komisioni për Zbatimin e Procedurave dhe Vlerësimin e Ofertave për Dhënjën në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronave të Paluajtshme të Komunës- i themeluar me vendim të Kuvendit të Komunës me nr.01/Nr.307/2026 të dt.29.01.2026, shpallë këtë:

NJOFTIM PËR PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME KOMUNALE


Me të cilin ftohen të gjithë të interesuarit, që të shfrytëzojnë të drejtën e bazuar në ligj për pjesëmarrje përmes shprehjes së interesit për marrjen në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme komunale, si më poshtë vijon:

I. Pronat e paluajtshme për dhënjën në shfrytëzim afatgjatë:


Nr. rendor	Nr. i parcesës	Zona kadastrale	Vendi i kuajtur	Sip.m ²	kultura	destinimi
1.	73317070-00927-0	Pustenik Hani i Elezit	Nikona	11710	arë e kl. 8	Bujqësi-Blegtori
2.	73317070-00946-0	Pustenik Hani i Elezit	Tanask	8906	kullosë e kl. 4	Bujqësi-Blegtori
3.	73317073-00792-0	Rezhancë Hani i Elezit	Ortica	19461	Kullosë e kl. 6	Bujqësi-Blegtori
4.	73317073-00789-1	Rezhancë Hani i Elezit	Gjuri	9510	Kullosë e kl.5	Bujqësi-Blegtori

II. Njoftimi mbi shpalljen e ofertës fituese:

1. Publikimi në tabelen e shpalljeve të komunës:



2. Publikimi në ueb faqen zyrtare të komunës:





REPUBLIKA E KOSOVËS--REPUBLIC OF KOSOVA
MUNICIPALITY OF ELEZ HAN
KOMUNA HANI I ELEZIT

Nr.02/2026

DATE:	13.06.2026
PËR:	KPF dhe Kuvendin Komunal
PËRMES:	z. Mehmet Ballazhi – Kryetar i Komunes Hani i Elezit
NGA:	Nexhmedin Daci– kryesues i komisionit vlerësues Majlinda Kaloshi- kryesuese e komisionit për ankesa
TEMA:	Shkresë përcjellëse- Propozim vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur për dhënen në shfrytëzim afatgjatë të paluajtshmërisë komunale

Të nderuar,

Me anë të kësaj shkrese përcjellëse ju përcjellim propozim vendimin për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga komisioni vlerësues për dhënen në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës.

Bashkëlidhur me propozim-vendimin keni:

-Raportin përfundimtarë të komisionit vlerësues dhe

-Raportin e komisionit për ankesa.

Me Respekt.



REPUBLIKA E KOSOVËS--REPUBLIC OF KOSOVA
MUNICIPALITY OF ELEZ HAN

KOMUNA HANI I ELEZIT



01/Nr./2026

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 12 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/4 Qershor 2008), Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës neni 19 paragrafi 3, Rregullores (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës neni 5 pika 1 paragrafi 1.3, nenit 6 paragrafi 3, nenit 13, nenit 21 paragrafi 5 dhe 6 si dhe nenit 22, Statutit të Komunës së Hanit të Elezit neni 25 pika d, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë xx.07.2026 merr:

**PROPZIM-VENDIM
PËR MIRATIMIN E OFERTËS SË PËRZGJEDHUR NGA KOMISIONI
VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË
PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS**

Neni 1

Miratohet në tërësi Raporti me nr. protokolli 01/5675 dt.25.06.2026 i Komisionit për Zbatimin e Procedurave dhe Vlerësimin e Ofertave lidhur me zhvillimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës përmes shprehjes së interesit.

Neni 2

Aprovohet rezultati i konkursit publik- përmes shprehjes së interesit, sipas të cilit ofertuesi ekonomikishtë më i favorshëm shpallet z.Bedri Imishti, nga Hani i Elezit, për parcelën me nr.P-73317073-00792 në sip. 19,461m² me kulturë kullosë e kl.6, vendi i quajtur Ortica- z.k. Rezhancë- Hani i Elezit, pronë e Komunës Hani i Elezit.

Neni 3

Autorizohet Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit që, në pajtim me dispozitat e Ligjit nr.06/L-092 dhe legjislacionin në fuqi të zhvilloj procedurat përfundimtare administrative dhe të nënshkruaj kontratën për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të parcelës së lartëcekur me ofertuesin fitues z. Bedri Imishti.

Neni 4

Kontrata do të përmbajë të gjitha kushtet e përcaktuara në: Njoftimin publik për shprehje të interesit me nr. protokolli 06/5054 dt.05.06.2026, ofertën e pranuar të ofertuesit fitues me nr. protokolli 01/5570 dt.22.06.2026, si dhe dispozitat e Ligjit nr.06/L-092 dhe Rregullores (QRK) nr.09/2020.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Bujqësisë si dhe njësitë administrative përgjegjëse të komunës.

Neni 6

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal,
- Arkivit i Komunës.

Hani i Elezi

Data: xx.07.2026

Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta



Republika e Kosovës - Republik of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02/Nr. 6398/2026

DATA:	13.07.2026
PËR:	Komitetin për Politik e Financa dhe Kuvendin e Komunës
NGA:	Kryetari i Komunës z.Mehmet Ballazhi <i>M. Ballazhi</i>
LËNDA:	Shkresë përcjellëse: Informatë për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtë mujorin e vitit 2026.



Me anë të kësaj shkrese ju përcjellim njoftimin për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtë mujorin e vitit 2026.

Me respekt

**INFORMATË PËR AKTIVITETE E KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË
BASHKËSI PËR GJASHTË MUJORIN E VITI 2026**

Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive në komunën e Hanit të Elezit për gjashtë mujorin e vitit 2026 ka mbajtur tri (3) mbledhje të rregullta.

Në takimet e rregullta të Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive zakonisht marrin pjesë:

1. Kryetari i komunës si kryesues i këshillit
2. Komandanti i stacionit policor
3. Përfaqësuesi i policia kufitare vija e gjelbërt
4. Përfaqësuesi i këshillit të bashkësisë islame
5. Kryesuesi i komitetit për komunitete
6. Zyrtari për Komunitete dhe Kthim.
7. Përfaqësuesi për barazi gjinore
8. Drejtori i drejtorisë për arsim
9. Përfaqësuesi i këshillit të prindërve
10. Përfaqësuesi i FSK-së
11. Drejtori i drejtorisë për shërbimeve publike dhe emergjencë
12. Përfaqësuesi i KVRL-së

Çështjet të cilat u trajtuan:-

- Siguria në komunën tonë.
- Siguria në Komunikacion.
- Çështja e investimeve kapitale që i ka komuna dhe pronat të cilat i posedon janë tu pasur shumë dëmtime siç po e shohim te parku i qytetit, parku Bllaca 99, te parku te Ura e Seçishtës dhe dëmtimet tjera që po bëhen në vazhdimësi në prona publike, dhe është kërkuar prej policisë që të ketë një angazhim pak më të madh sa i përket kësaj çështje.
- I është rekomanduar policisë për çështjen e parkingut që është për persona me aftësi të kufizuara që mos të jetë i zënë.
- Është rekomanduar që policia të vazhdon të qendronë në pikën te shkolla fillore "Ilaç Thaçi në dy ndërrime.
- Është diskutuar çështja e dukurive negative edhe nëpër fshatra, droga, bixhozi teknologjik dhe është kërkuar nga policia që kërkon nga njësitet përgjegjëse të policisë për këtë çështje dhe të bashkëpunon me qytetarë dhe të merr veprime.
- Transporti ilegal i druve.
- Është diskutuar çështja e lypsarëve dhe është kërkuar nga policia që ta trajton këtë çështje.
- Çështja e zjarreve.
- Është diskutuar çështja e qenve endacak por nuk kemi mundur me bërë asgjë për shkak se Ligji nuk na lejon.
- Çështja e migrantëve ilegal.



Republika e Kosovës – Republic of Kosovo
Ndërmarrja Publike Lokale
“PASTRIMI”SH.A
Hanë Elezit



01/Nr. 6520 /2026

Data:	14.07.2026
PËR:	KPF dhe Kuvendin e Komunës së Hanit të Elezit
PËRMES:	Kryesuese e Komisionit të Aksionerëve – <u>Sevime Bajrami</u>
NGA:	Ndërmarrja Publike Lokale e Mbeturinave - NPL “PASTRIMI” SH.A
LËNDA:	Informatë mbi Raportin për periudhën Janar – Qershor /2026

Të nderuar anëtarë të KPF-së dhe Kuvendit të Komunës

Me anë të kësaj shkrese po ua përcjelli raportin për periudhën janar - qershor /2026 të Ndërmarrjes Publike Lokale të Mbeturinave - NPL “Pastrimi” Sh.a.

Me respekt,



Republika e Kosovës- Republic of Kosova
Ndërmarrja Publike Lokale
"PASTRIMI"SH.A
Hani i



Elezit

Nr.Prot. /2026

Data:	14.07.2026
PËR:	KPF dhe Kuvendin e Komunës së Hanit të Elezit
PËRMES:	Kryesues i Komisionit të Aksionarëve – znj.Sevime Bajrami
NGA:	Ndërmarrja Publike Lokale e Mbeturinave - NPL"PASTRIMI" SH.A
LËNDA:	Informatë mbi raportin për periudhën Janar – Qershor /2026 – Npl"Pastrimi" Sh.a

Të nderuar anëtarë të KPF-së dhe Kuvendit të Komunës

Në këtë raport janë të pasqyruara aktivitet operative dhe financiare për periudhën Janar – Qershor / 2026 për Ndërmarrjen Publike Lokale të Mbeturinave - Npl "Pastrimi" Sh.a.

Me respekt,

RAPORTI PËR PERIUDHËN JANAR – QERSHOR / 2026, I NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE TË MBETURINAVE - NPL"PASTRIMI" SH.A

Ky raport është përgatitur për periudhën Janar – Qershor / 2026, në bazë të ligjit për Ndërmarrjet Publike - Ligjit Nr.03/L-087, të nenit 31 dhe nenit 14, paragrafit 14.2 dhe Statutit të Ndërmarrjes Publike Lokale "Pastrimi" Sh.a. Ndërmarrja Publike Lokale – NPL "PASTRIMI" SH.A, bënë menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës Hanit të Elezit, ku përfshihen të gjitha lokalitetet e Komunës.

Ndërmarrja Publike Lokale – Npl"Pastrimi" Sh.a, ka gjithësej njëzete një punëtor (21) punëtorë :

- 1 Kryeshef Ekzekutiv
- 1 Sekretar i Ndërmarrjes
- 1 Arkëtare (ushtruese detyre e ZKF –së)
- 1 Inkasant
- 1 Mirembajtës i parqeve publike
- 3 Shofer
- 5 Punëtor teknik
- 8 Pastrues (Grumbullues të mbeturinave)

Sa i përket kësaj periudhe Janar – Qershor 2026, mund të themi se gjatë kësaj periudhe ka qenë një periudhë me mjaft aktivitete nga punëtorët e ndërmarrjes publike lokale "Pastrimi". Gjatë kësaj periudhe punëtorët e kompanisë kanë qenë të angazhuar në terren në kryerjen e shërbimit të mbeturinave dhe njëkohësisht kanë kryer pastrimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve në qendër të Hanit të Elezit, pastrimin dhe kositjen e skajeve të rrugëve në fshatra përreth, pastrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve në Pustënik, pastrimin dhe mirembajtjen e parkut të qytetit "Isa Berisha", parkut të rruga Lepenci, pastrimin e përronjëve si atë në Seçishtë dhe tek perroi i Dimcës, përroit në Lagje të Re.

Gjatë kësaj periudhe ndërmarrja ka realizuar shërbimet sipas planit operativ, duke iu përgjigjur me kohë kërkesave të qytetarëve dhe institucioneve. Përveç aktiviteteve të rregullta, ekipet kanë intervenuar edhe në raste emergjente për largimin e mbeturinave dhe pastrimin e hapësirave publike, me qëllim të ruajtjes së pastërtisë, higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit. Gjithashtu është bërë monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes së automjeteve dhe pajisjeve të punës, për të siguruar ofrimin e pandërprerë dhe efikas të shërbimeve.

Sa i përket politikave të arkëtimit të obligimeve nga ana e klientëve, kompania ka vazhduar me zbatimin e politikave për rritjen e nivelit të arkëtimit të obligimeve, përmes njoftimeve me shkrim, kontakteve të drejtpërdrejta me klientët dhe rikujtimeve për pagesë, si rezultat i këtyre aktiviteteve është shënuar një përmirësim i pagesave të detyrimeve nga një pjesë e konsiderueshme e klientëve, duke ndikuar pozitivisht në stabilitetin financiar të ndërmarrjes.

Në përgjithësi, gjatë periudhës Janar-Qershor 2026, kompania ka realizuar me sukses detyrat dhe përgjegjësitë e saj, duke ofruar shërbime të rregullta për qytetarët, duke përmirësuar mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe duke ndërmarrë masa për rritjen e efikasitetit operacional dhe performancës financiare.

Lista e punëtorëve të NPL-së, pozita e vendit të punës dhe paga e tyre si vijon:-

Nr.	Pozita	Nr. Punëtorëve	Paga Bruto
1	Kryeshefi Ekzekutiv	1	880.82
2	Sekretar i Ndërmarrjes	1	568.21
3	Arkëtare	1	568.21
4	Shofer – mbykqyres i punëtorve në teren	1	568.21
5	Shofer	2	512.84
6	Inkasant	1	512.84
7	Mirëmbajtës i parqeve publike	1	447.35
8	Grumbullues i mbeturinave	8	447.35
9	Punëtor teknik	5	447.35
11	TOTALI I STAFIT TË NPL-SË	21	

Gjatë periudhës Janar –Qershor /2026, janë mbajtur katër (4) mbledhje me Bordin e Drejtorëve të Npl "Pastrimi" Sh.a. ;

Gjatë kësaj periudhe është propozuar dhe miratuar nga Kuvendi Komunal ngritja e pagave për puntorët e kompanisë , ku Komuna ka subvencionuar ndërmarrjen në shumën prej 25.000 € me qëllim që të mbulohet ngritja e pagave për punonjësit e NPL-së me qëllimin në përmirësimin e kushteve të punës dhe motivimin e stafit, rritjen e efikasitetit dhe produktivitetit në punë, si dhe ruajtjen e stafit ,duke pasur parasysh rritjen e kostos së jetesës.Ky ndryshim do të hyj në fuqi menjëherë nga muaji Korrik 2026 dhe aplikohet për të gjithë punonjësit aktivë te NPL-së.

Çmimet e kontratave janë:

- Kontratë familjare **6.50 €**, në muaj,
- Kontratë e mesme **10.40 €**, në muaj,
- Kontratë me zbrazje **16.90 €**, për çdo zbrazje të kontenjerit **1100L**.

Gjatë periudhës Janar–Qershor /2025 janë nënshkuar disa kontrata me klient të rinj të Npl"Pastrimi" Sh.a, ato janë:-

- Kontratë familjare **8**,
- Kontratë biznesore **3**,
- Institucionale **0**.

Totali i kontratave të nënshkuara nga viti 2017 –Qershor / 2026 janë si vijon:-

- Ekonomitë familjare ----- **1350**
- Kontratë biznesore ----- **119**
- Kontratë institucionale ----- **11**
- Totali i kontratave ----- **1480**

1. Hyrje

Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2026, është përgatitur në bazë të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, të nenit 14, paragrafët 14.2 si dhe statutit të Ndërmarrjes Publike Lokale.

Ky raport përmban një përmbledhje të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore të kompanisë së mbeturinave përgjatë periudhës Janar – Qershor 2026. Raporti pasqyron të hyrat e kompanisë, si dhe krahasimet me periudhën paraprake.

Performanca e të hyrave nga shërbimet

Të hyrat nga shërbimet në periudhën raportuese Janar – Qershor 2026 kanë arritur vlerën 134,407.46 euro duke shënuar rritje me 8.50% që korrespondon me 10,529.73 euro më shumë krahasuar me të hyrat e të njëjtes periudhe të vitit 2025.

Performanca e shpenzimeve të kompanisë

Shpenzimet e kompanisë në periudhën raportuese kanë arritur vlerën prej 130,780.05 euro duke shënuar një rritje prej 17.72 % që korrespondon me 19,689.87 euro më shumë krahasuar me periudhën e njëjte të vitit paraprak.

- Shpenzimet për paga dhe mëditje në periudhën raportuese shënuan vlerën e 77,534.25 € duke shënuar një rritje prej 15,092.06 € apo 24.17% krahasuar me vitin 2025.
- Shpenzimet për mallra dhe shërbime në periudhën raportuese shënuan vlerën prej 53,198.38 € duke shënuar një rritje prej 5,859.17 € apo 12.38 % krahasuar me vitin 2025.

2. TË HYRAT E KOMPANISË

	TE HYRAT	2025	2026	Ndryshimi €	Ndryshimi %
1	Të hyrat nga Shërbimet	123,877.73	134,407.46	10,529.73	8.50%
2	Te hyra tjera	452.80	1,200.00	747.20	165.02%
3	Paraja në bankë	-	-	-	#DIV/0!
4	Te hyra nga donacionet	-	25,000.00	25,000.00	100.0%
	TOTALI	124,330.53	160,607.46	36,276.93	29.18%

3. SHPENZIMET E KOMPANISË

3.1 PAGA DHE MEDITJE

A	PAGAT DHE MEDITJET	2025	2026	Ndryshimi €	Ndryshimi %
1	PAGAT NETO + SHUJTA	54,415.90	67,262.18	12,846.28	23.61%
2	KONTRIBUTI I PUNEMARRSIT	2,973.45	3,692.11	718.66	24.17%
3	KONTRIBUTI I PUNEDHENESIT	2,973.45	3,692.11	718.66	24.17%
4	TATIMI NE BURIM	2,079.39	2,887.85	808.46	38.88%
	TOTALI	62,442.19	77,534.25	15,092.06	24.17%

3.2 Tatimet

B	TATIMET	2025	2026	Ndryshimi €	Ndryshimi %
1	TVSH-ja 8%		-	-	
2	KESTET TREMUJORE (ATK)	-	-	-	
3	TATIMI VJETOR MBI KORPORATA	1,308.78	47.42	(1,261.36)	-2659.97%
	TOTALI	1,308.78	47.42	(1,261.36)	-2659.97%

3.3 MALLRA DHE SHERBIME

C	MALLRA DHE SHËRBIME	2025	2026	Ndryshimi €	Ndryshimi %
1	Shpenzime për karburant	10,998.43	16,637.75	5,639.32	51.27%
2	Shpenzimet e deponisë (KMDK)	6,281.16	7,020.90	739.74	11.78%
3	Shpenzimet për internet	127.12	139.83	12.71	10.00%
4	Shpenzimet e Mirëmbajtjes së Mjeteve	16,253.81	19,566.59	3,312.78	20.38%
5	Furnizim me Rërë I II III	-	-	-	-
6	Shpenzime për Softuer Kompjuterik	250.00	250.00	-	0.00%
7	Shpenzime për zyre dhe administrative	2,960.82	3,533.37	572.55	19.34%
8	Shpenzime për pajisje dhe mjete pune	4,696.37	2,725.61	(1,970.76)	-41.96%
9	Shpenzime për trajnime	-	-	-	
10	Shpenzimet e Reprerentacionit	558.40	496.10	(62.30)	-11.16%
11	Shpenzimet e Sigurimit	1,994.62	610.00	(1,384.62)	-69.42%
12	Shpenzime Telefoni - (Mbushje)	500.00	503.40	3.40	0.68%
13	Provizione Bankare NLB BANK	118.30	81.50	(36.80)	-31.11%
14	Çertifikata për shofer kamioni	-	-	-	
15	Çertifikata shëndetsore	-	-	-	
16	Shpenzimet hixhienike	2,442.08	332.30	(2,109.78)	100.00%
17	Uniforma Pune		713.14	713.14	100.00%
18	Licence		-	-	
19	Shpenzimet e punes ne terren		15.25	15.25	100.00%
20	Shpenzimet e pazbritshme për qeshtje tatimore		151.00	151.00	100.00%
21	Shpenzimet e rrymes	158.10	421.64	263.54	100.00%
	TOTALI	47,339.21	53,198.38	5,859.17	12.38%

3.4 TOTALI I TE HYRAVE DHE SHPENZIMEVE

	TE HYRAT	2025	2026	Ndryshimi €	Ndryshimi %
1	Të hyrat nga Shërbimet	123,877.73	134,407.46	10,529.73	8.50%
2	Te hyra tjera (Ministria e Punes)	452.80	1,200.00	747.20	165.02%
3	Paraja në bankë	-	-	-	0.00%
	TOTALI	124,330.53	135,607.46	11,276.93	9.07%
	SHPENZIMET				
	Totali i shpenzimeve A+B+C+D+E	111,090.18	130,780.05	19,689.87	17.72%

Llogaritja e te hyrave dhe shpenzimeve Janar - Qershor 2026

N.P.L. " PASTRIM
NRU: 811167271
Hani i Elezit Rr " D

A	TE HYRAT	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	TOTALI
1	Të hyrat nga Shërbimet	27,488.86	21,525.81	21,826.76	21,465.53	21,622.42	20,478.08	134,407.46
2	Te Hyra Tjera (Ministria e Punes)	600.00	600.00	-	-	-	-	1,200.00
	TOTALI	28,088.86	22,125.81	21,826.76	21,465.53	21,622.42	20,478.08	135,607.46
B	SHPENZIMET E KOMPANISË	1	2	3	4	5	6	TOTALI
B	PAGAT DHE MEDITJET	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	TOTALI
1	PAGAT NETO + SHUJTA	9,978.92	9,871.14	10,771.08	11,140.76	12,793.76	12,706.52	67,262.18
2	KONTRIBUTI I PUNEMARRSIT	545.08	538.77	593.07	613.01	704.31	697.87	3,692.11
3	KONTRIBUTI I PUNEDHENESIT	545.08	538.77	593.07	613.01	704.31	697.87	3,692.11
4	TATIMI NE BURIM	377.51	365.54	497.19	506.55	588.38	552.68	2,887.85
	TOTALI	11,446.59	11,314.22	12,454.41	12,873.33	14,790.76	14,654.94	77,534.25
C	MALLRA DHE SHËRBIME	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	TOTALI
1	Shpenzime për karburant	2,523.11	2,319.36	3,272.88	4,729.36	3,793.04		16,637.75
2	Shpenzimet e deponisë (KMDK)	1,862.09	1,557.94	-	1,803.01	1,797.86		7,020.90
3	Shpenzimet për internet	139.83	-	-	-	-		139.83
4	Shpenz. e mirembajtjes se mjeteve dhe objekteve	2,306.90	2,218.05	2,134.15	6,709.17	1,700.35	4,497.97	19,566.59
5	Furnizim me Rere I II III							-
6	Shpenzime për Softwer Kompjuterik					250.00		250.00
7	Shpenzime per Zyre dhe administrative	300.00	300.00	300.00	588.00	1,184.66	860.71	3,533.37
8	Shpenzime per pajisje dhe mjete pune		888.98		850.00	83.36	903.27	2,725.61
11	Shpenzime per trajnime							-
12	Shpenzimet e Reprerentacionit		70.00		108.47	237.29	80.34	496.10
13	Shpenzimet e Sigurimit				610.00			610.00
14	Shpenzime Telefoni - (Mbushje)	83.90	83.90	83.90	83.90	83.90	83.90	503.40
15	Provizione Bankare NLB BANK	19.10	12.90	14.50	18.50	16.50		81.50
16	Certifikata per shofer kamioni							-
17	Certifikata shendetore punetor							-
18	Shpenzime hixhienike	84.58	104.49				143.23	332.30
19	Uniforma Pune	713.14						713.14
21	Licenca							-
22	Shpenzimet e punes ne terren	-				151.00	15.25	15.25
23	Shpenzimet e pazbritshme per qeshnje tatimore							151.00

	TOTALI	8,032.65	7,555.62	5,805.43	15,500.41	9,297.96	6,584.67	52,776.74
D	Shpenzime Komunale							-
	Shpenzimet e Rrymes	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	TOTALI
	Ujesjellesi	-	158.49	158.23	104.92	-		421.64
	TOTALI	-	158.49	158.23	104.92	-	-	421.64

E	TOTALI I SHPENZIMEVE (B+C+D+E)	19,479.24	19,028.33	18,418.07	28,478.66	24,088.72	21,239.61	130,732.63
---	--------------------------------	-----------	-----------	-----------	-----------	-----------	-----------	------------

F	FITIMI PARA TATIMIT (A-E)	8,609.62	3,097.48	3,408.69	(7,013.13)	(2,466.30)	(761.53)	4,874.83
G	T. ne fitim (Tatimi ne te ardhura te korporatave) (F*10)	860.96	309.75	340.87	-	-	-	47.42
H	FITIMI NETO (F-G)	7,748.66	2,787.73	3,067.82	(7,013.13)	(2,466.30)	(761.53)	4,827.41